



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
16 MAJ 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
16. MAJA 2008. GODINE

Maj 2008

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën jokontestimore,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për procedurën përmbartuese,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorimin civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me procedimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
10. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarit të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK- së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare,
12. Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

D n e v n i r e d

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica od 18 i 21, kao i 29 aprila 2008. godine,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje N/Z o izmenama i dopunama Zakona o šumama,
4. Prvo razmatranje N/Z o nacionalnim kvalifikacijama,
5. Drugo razmatranje N/Z o vanparničnom postupku,
6. Drugo razmatranje N/Z o izvršnoj proceduri,
7. Drugo razmatranje N/Z o materijalnoj podršci porodicama dece sa stalno ograničenim sposobnostima,
8. Drugo razmatranje N/Z o civilnoj upotrebi eksploziva,
9. Razmatranje preporuke Komisije za Budžet i Financije o prosleđivanju Nacrta zakona o sprečavanju pranja novca,
10. Razmatranje predloga Vlade o imenovanju člana Borda Centralnog Bankarskog Autoriteta Republike Kosova,
11. Razmatranje predloga PG LDK-a za zamenu članova parlamentarnih komisija, i
12. Razmatranje predloga parlamentarnih grupa za imenovanje članova Saveta Agencije protiv korupcije.

A g e n d a

1. Approval of minutes of the plenary sessions held on 18, 21 and 29 April 2008,
2. Time for Parliamentary questions,
3. First reading of the Draft Law on amendments and additions of Law on Forests,
4. First reading of the Draft Law on National Qualifications,

5. First reading of the Draft Law on Out Contentious Procedure,
 6. Second reading of the Draft Law on Executive Procedure,
 7. Second reading of the Draft Law on Material Support for Families of Children with Permanent Disability,
 8. Second reading of the Draft Law on Civil Use of Explosives,
 9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me procedimin e Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave,
 10. Discussion of the Government proposal on appointing a member of Central Bank Authority Board of Republic of Kosovo,
 11. Discussion of the proposal of LDK Parliamentary Group for the replacement of members in Parliamentary Committees,
 12. Discussion of the proposals of Parliamentary Groups on appointing the members of the Council of the Agency against corruption.
-

Seanca filloi në orën 10,00

Seancën e drejtoi, zoti **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës të Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, Kryesia e ka përgatitur dhe ia paraqet rendin e ditës Kuvendit për seancën plenare.

Ndërkohë, pas kërkesës së bërë nga Kryesia e Kuvendit, ka arritur propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e anëtarëve të organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Për arsye të urgjencës që ka emërimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit, propozoj që të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës:

- Emërimi i organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Nëse nuk ka vërejtje nga shefat e grupeve parlamentare, kërkoj deklarin e seancës plenare për një votim formal për t'u plotësuar rendi i ditës.

Lus deputetët që, me ngritjen e dorës, të deklarojnë kush është “për”.

Faleminderit!

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? 2 abstenime.

Konstatohet se u miratua propozimi që kjo pikë të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës për seancën e sotme plenare.

Për fjalë është paraqitur deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Zoti Kryetar,

Unë, më 23 prill kam proceduar një kërkesë si propozim për rendin e ditës, e cila ka të bëjë me nxjerrjen e një deklarate politike nga Kuvendi dhe për përgatitjen e një aktpadie kundër ish-kryeprokurores së Tribunalit të Hagës.

Në mbledhjen e kaluar, është kumtuar se kërkesa është shtyrë për këtë seancë dhe, për çudi, unë nuk e shoh se është e futur në rend të ditës për seancën e sotme.

Kërkesa i plotëson kushtet, është e mbështetur nga 5 deputetë të tjerë dhe afati i shqyrtimit të kërkesës është brenda 20 ditëve. Do të thotë, sot do të duhej, patjetër, të jetë në rend të ditës.

Unë kërkoj që kërkesa të futet në rend të ditës dhe të shqyrtohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është proceduar dhe, sipas Rregullores së Punës, nga dita e marrjes së kësaj shkrese, mund të hyjë në rend të ditës. Do të thotë, në seancën e ardhshme, do të jetë në rend dite.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare, të mbajtur më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca, iu janë shpërndarë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbale? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 18 e 21 dhe më 29 prill 2008.

Pika e dytë e rendit të ditës, është:

- Pyetjet parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Nga seanca e kaluar janë mbartur 6 pyetje për përgjigje me gojë.

Në afatin e përcaktuar me Rregullore janë parashtruar 24 pyetje për përgjigje me gojë, të cilat do të procedohen sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Deputeti Esat Brajshori – AKR, pyetje për ministrin e Transportit dhe Posttelekomit, Fatmir Limaj.

Ministri është në udhëtim zyrtar. Zotëri deputet, a doni ta lexoni pyetjen apo doni ta lëni për seancën e ardhshme? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka – AKR, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Në këtë pyetje mund të përgjigjet edhe zëvendëskryeministri.

Zoti deputet, a doni ta parashtroni pyetjen? Urdhëroni!

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar,
Të nderuar qeveritarë,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Pyes zotëri zëvendëskryeministrin Kuçi, se Qeveria e Kosovës e ka apo s'e ka ndërmend, apo në agjendë, për ta përgatitur Ligjin sistemor për tokat.

Tokat, sot në Kosovë, intensivisht, pa kurrfarë mëshire e pa kurrfarë skrupulli shkatërrohen, devastohen, uzurpohen me objekte inproduktive dhe dëmtohen. Konsiderohet se afër 2.000 hektarë tokë buke në vit shkatërrohen në Kosovë, kurse ne i kemi krejtësisht 10.000 kilometra katrorë. Ose, zyrtarisht: 10.800 kilometra katrorë.

Ju lutem, në këtë drejtim, a mund ta presim një projektligj sistemor për tokat, tokën bujqësore, tokat rekreative, pyjet, tokat ndërtimore, parqet kombëtare, e tjera. Faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti profesor, për pyetjen! Natyrisht se është një pyetje me rëndësi dhe është diçka që rikujton edhe Qeverinë edhe të tjerët që kanë nevojë ta bëjnë.

Ne kemi menduar që ta zgjidhim këtë problem përmes Ligjit për pronën. Do ta shqyrtojmë me ekspertët tanë dhe me siguri do ta marrim këtë parasysh.

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Deputeti Riza Smaka, e ka fjalën.

RIZA SMAKA: Mendoj se kjo çështje duhet të merret si serioze. Është jetike për ekonominë, për politikën, për socialen, për kulturën e popullit të Kosovës dhe të Kosovës. Unë do të kisha pasur dëshirë që këtë ligj ta bëjmë sa më parë që është e mundshme. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetja e radhës.

Deputeti Esat Brajshori – AKR, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotin Valton Beqiri.

E ka fjalën deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Shfrytëzoj rastin që ministrit të ri t'i uroj sukses!

Pyetja është kjo: Qyteti antik iliro-dardan – Ulpiana, është pronë ose nën mbrojtjen e Muzeut të Kosovës që nga viti 1955 dhe kap një sipërfaqe prej 88 ari, edhe pse, sipas arkeologëve, mendohet se Ulpiana është e shtrirë në një sipërfaqe prej 100 hektarësh.

Dihet se ky qytet antik, arkivon etnogjenezën dhe identitetin e shqiptarëve të sotëm, si garanci për të mos lejuar konvertimin e tyre përkundër trysnive gjatë shekujve.

Sot, me prerjet cezarike, ju e kuptoni, me këtë dua të them: decentralizimin e kufijve ndërkomunal, mund të denigrojë krejtësisht këtë qytet, nga i cili u lind Kosova e sotme. Sot kur hidhen ide që Prishtina e re të ndërtohet pikërisht në hapësirat e vendbanimit antik të Ulpianës, pyes:

- Çfarë masash ka ndërmarrë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që qyteti antik, Ulpiana, të merret në mbrojtjen e UNESCO-s si trashëgimi kulturore e dorës së parë?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI VALTON BEQIRI: I nderuar, zoti Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ndër qytetet më të rëndësishme të antikitetit radhitet Ulpiana dhe gjendet rreth 7 kilometra në juglindje të Prishtinës, në fshatin Graçanicë. Zbulimet arkeologjike të një vendbanimi të Palafit nga epoka e Neolitikut, pra mijëvjeçarit të tretë para Krishtit, grupi i varreve dardane me urne rreth shekullit VIII, IX para Krishtit, qeramika e fazës së parë të hekurit dhe stolitë e shekullit IV para Krishtit – dëshmojnë se Ulpiana ishte ngritur mbi bërthamën e një vendbanimi dardan, në shekullin I, pra, pas Krishtit. Në fillim të shekullit II, gjatë sundimit të mbretit Trajan kishte fituar statusin e municipit si qytet i fortifikuar.

Qyteti pra, është i rrethuar me mure të gjera deri në 3 metra dhe nga 2 kulla gjysmërrethi në çdo 27.5 metra dhe ka trajtë të parregullt katërkëndëshi. Ulpiana, së bashku me Justinopolin, paraqet pra lagjet e varrezat e tjera në sipërfaqe prej rreth 120 hektarë.

Kërkimet arkeologjike jashtë mureve të qytetit kanë qenë filluar nga vitet 1953 dhe janë përqendruar në zbulimin e objekteve brenda këtij qyteti.

Ministria e kulturës ka kontaktuar me përfaqësues të UNESCO-s, të cilët kanë vizituar Kosovën dhe kanë trajtuar çështjen e Ulpianës, qytetit të Prizrenit dhe objektet tjera, të cilat janë pretendente të jenë pasuri botërore.

Më duhet t'ju tregoj se anëtarësimi ynë në UNESCO lidhet ngushtë me anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe mendoj se pas zgjidhjes së kësaj çështjeje të Kosovës, pra tani, dhe pranimin të Republikës së Kosovës në organizmat ndërkombëtar, edhe për ne si Ministri e Kulturës dhe Rinisë e Sporteve do të hapen rrugë që kjo pasuri të mos jetë vetëm pasuri e Kosovës, por të jetë edhe pasuri botërore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Zoti deputetë, keni pyetje shtesë? Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar! Faleminderit, zoti ministër!
Ndërlidhja e çështjes me UNESCO-n, sa i përket njohjes së Kosovës në Këshillin e Sigurimit – në OKB, nuk qëndron, sepse ne kemi arsye të themi se Deçani, për shembull, Manastiri është pranuar më 2004 si pasuri kulturore trashëgimtare dhe unë edhe një herë e përsëris:

- Dua agjendën e ministrit në lidhje me këtë çështje me UNESCO-n. Keni agjendë, apo nuk keni, për këtë çështje?

Arsyetimi që ishte i mëhershëm, u kuptua, nuk qëndron. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër?

VALTON BEQIRI: Faleminderit! E përmendët, pra, një rast të vitit 2004. E kam për obligim të tregoj se kjo ka hyrë në mbrojtjen e UNESCO-s përmes një epiteti tjetër shtetëror dhe ta keni parasysh. Agjenda është e tillë, se ne kemi kontaktuar me ekspertë dhe duhet të kthehem në pyetjen e parë e t'ju tregoj se lokaliteti i Ulpianës gjendet rreth 1 kilometër jashtë zonës së mbrojtur, pra edhe me pakon e re të Ahtisarit, prandaj është një përparësi për ne që të shkojmë përpara dhe të kërkojmë që ky lokalitet të jetë gjithsesi në mbrojtje të UNESCO-s dhe të kemi mundësi të kryejmë punët tona arkeologjike dhe shpresoj se do të gjejmë zgjidhje për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Vazhdojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Kryeministri, nuk është këtu. Kryeministri ia ka adresuar pyetjen ministrit të Ambientit. Edhe ministri i Ambientit, nuk është këtu. Doni ta parashtroni pyetjen, zoti deputet? E ka fjalën deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Faleminderit! Është dukuri tepër negative prerja e pyjeve në mënyrë sistematike, krejtësisht të paskrupullt, pa dhembje – sikur të ishin pyje të huaja dhe pasojat janë tepër të dëmshme. Shterja e lumenjve, pastaj përdorimi i drurit si lëndë e parë, eksportimi kryesisht si lëndë e parë, importimi i produkteve finale, që është dukuri më e shëmtuar e vendeve të prapambetura, që do të duhej të bëhej e kundërta, apo diçka ngjashëm, që të përpunohen këto.

Konsiderohet, edhe pse nuk ka statistika, por konsiderohet se me mijëra hektarë brenda vitit shkatërrohen pyje. Ndërkohë, kemi marrë një Projektligj për ndryshime e plotësime të Ligjit për pyjet, por ai nuk i jep zgjidhjet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Ju lus, respektojeni kohën! Ministër i Bujqësisë, a doni të përgjigjeni në pyetjen, pasi që ka të bëjë me pyjet. Nëse jo, faleminderit! Vazhdojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. A doni ta lexoni pyetjen? Fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra dhe deputetë,
Pyetja është përkitazi me kaptazhimin dhe uzurpimin arbitrar të burimeve ujore.

Burimet ujore janë respublika, janë pronë publike. Ato, me të madhe uzurpohen, kaptazhohen. Në fushat tona, pyjet tona, në vendet që janë shumë të përshtatshme për rekreacion dhe për nevoja vitale, shteren, do të thotë mbulohen dhe ato burime uzurpohen arbitrarisht.

Ju lutem, pyetja është kjo:

- Çfarë duhet bërë Qeveria që kjo dukuri të tejkalohet dhe të kthehen ato burime që ishin natyrore, në burime natyrore?

Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Kryeministri, nuk është këtu. Ministri i ambientit, po ashtu nuk është. Megjithatë, presim përgjigjen në seancën e ardhshme.

Vazhdojmë me pyetjen e radhës:

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministren e Energjetikës dhe të Minierave, Justina Pula.

Ministrja nuk është këtu! Deputete, a doni ta bëni pyetjen? Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu.

LULJETA SHEHU: Do ta bëj herën tjetër, atëherë kur do të jenë prezent ministrja.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Pyetja e radhës.

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!
Të nderuar ministra dhe deputetë të respektuar,
Pyetja është për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Në kuadër të programeve shkollore, respektivisht në kurrikulumet e tyre a ka filluar të implementohet strategjia - Shkollat promovuese të shëndetit. Strategjia është për periudhën 2008-2017. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti Kryetar,
Të nderuar zotërinj ministra,
Të nderuar deputetë,
Një strategji e tillë sapo është në fazën finale të përgatitjes së saj dhe si vërtet të implementohet meqë strategjitë janë dokumente orientuese, por jo patjetër mund të

zbatohen në formën se si janë. Në Prizren dhe në qytete të tjera të Kosovës veç është promovuar një pjesë e Strategjisë për shkollat e shëndetshme. Kemi bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe jemi shumë të sigurt që në fazën që e parasheh strategjia, vërtet të ndodhë edhe implementimi i saj.

Përveç kësaj, edhe në ndërtimin e objekteve të reja shkollore parashihet që në secilën godinë shkollore të ketë ambulanca të cilat do të jenë në shërbim të nxënësve. Ndër problemet kryesore, me të cilat nxënësit sot ballafaqohen në rrafshin shëndetësor, janë mbi të gjitha çështja e kariesit që është shumë i përhapur në mesin e nxënësve dhe çështja e strabizmit për shkak të përdorimit të mjeteve teknologjike, qoftë në mësimdhënie, qoftë në mësimnxënie dhe qoftë edhe për lojëra të ndryshme.

Prandaj, për Ministrinë e Arsimit, për Qeverinë e Kosovës dhe për të gjithë kolegët që janë në Qeveri, çështja e implementimit të kësaj strategjie është vitale. Organizata shëndetësore e shëndetësisë ka bërë një punë jashtëzakonisht të madhe, kështu që ne jemi të përkushtuar që thjeshtë implementimi i saj të ndodhë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, keni pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Urdhëroni, deputete Hulaj!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit! Me qëllim të parandalimit të etheve hemorragjike - sëmundje transmise virale në vendin tonë, e cila çdo vit paraqitet në forma hiperendemike dhe epidemike, sidomos në vatrën e evidentuara me raste të etheve hemorragjike të komunave: Pejë, Drenas, Lipjan, Podujevë, Prizren, Rahovec, Klinë, Burim, Gjakovë, Malishevë, Kastriot, Gjilan, Therandë, Kaçanik dhe Skenderaj. Në këto zona jetojnë më shumë se gjysma e popullatës së Kosovës dhe kjo e bën këtë problematikë edhe më serioze. Sëmundja është e karakterit sezonal pranverë-verë.

Edhe përkundër rezultateve të arritura, kërkohet implementim dhe matje strategjike e rezultateve.

Pyetja është:

- A ka filluar të implementohet strategjia për parandalimin dhe eliminimin e etheve hemorragjike në Kosovë?

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri.

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë, doktoreshë Nurishahe! Ju falënderoj për kontributin shumëvjeçar lidhur me eliminimin, parandalimin dhe eliminimin e etheve hemorragjike.

Mund t'ju them se lidhur me këtë çështje kemi lajme shumë të mira. Vendi ynë, Kosova, e ka strategjinë për parandalimin dhe eliminimin e etheve hemorragjike.

Nën dy. Këto ditë, Kosova e ka fituar të drejtën nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe është certifikuar për të gjitha ekzaminimet për diagnostifikimin e kësaj sëmundjeje, e

cila, për vendin tonë, ka paraqitur problem deri më tash dhe nuk përjashtohet mundësia që ne të gjithëve do të na nevojitet një angazhim shtesë për këtë çështje.

Fillimi dhe implementimi i kësaj strategjie kërkon buxhet. Kuvendi i Kosovës, nuk ka ndarë buxhet për implementimin e kësaj strategjie. Megjithatë, duke llogaritur në përkushtimin e profesionistëve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, vendimi është që nga të hyrat vetjake për të cilat, për herë të parë kemi arritur para një jave të marrim vendim qeveritar, fillon zbatimi i kësaj strategjie.

Ju përkujtoj se bartës të zbatimit të strategjisë janë: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ambientit, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe kuvendet komunale.

Shfrytëzoj rastin t'i falënderohem Komandantit mjekësor të KFOR-it, doktor Trap, i cili ka mundësuar dhe vërtet mbështet ekspertizën nga Mynihu për ngritjen e cilësisë së laboratorit tonë – si një nga laboratoriumet e vetme rajonale për këtë çështje. Deri më tani, këto ekzaminime janë kryer në Slloveni, ndërsa rikonfirmimi është bërë në kontinuitet në Mynih. Këtu, për 12 orë do të kemi diagnozë, ndërsa ekziston marrëveshja që konfirmimin ose rikonfirmimin, apo kontestimin e diagnozës, ta bëjë një nga laboratoriumet më të mira që ekzistojnë sot, në Mynih. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër. Deputete, a doni të parashtroni pyetje shtesë? Jo. Faleminderit!

Deputetja Nurhishahe Hulaj, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Ministri ka njoftuar me shkrim se është në udhëtim zyrtar. A doni ta bëni pyetjen? E ka fjalën deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Është vonuar shumë derisa ka arritur pyetja këtu, prandaj edhe kisha për ta lexuar.

Në bazë të Udhëzimit administrativ Numër 2008/1, neni 4. 4, ku thuhet: Të hyrat vetjake do të alokohen pasi që mjetet do të jenë në dispozicion në llogarinë kryesore bankare të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Alokimi do bëhet në bazë të kërkesës dhe destinimit të organizatës buxhetore. Kërkesat e organizatave shëndetësore për kthimin e mjeteve vetjake ekzistojnë në Ministrinë e Shëndetësisë bashkë me planin rrjedhës se ku do të shfrytëzohen mjetet vetjake të organizatës shëndetësore buxhetore.

Pyetja e parë, është:

- A është nënshkruar Memorandumi i mirëkuptimit në mes të MEF-it dhe Ministrisë së Shëndetësisë për kthimin e mjeteve të të hyrave vetjake dhe bashkëpagesave organizatave shëndetësore?

Nëse është nënshkruar memorandumi, kur do të kthehen mjetet e të hyrave vetjake organizatave shëndetësore buxhetore, meqenëse edhe muaji maj po kalon dhe konsideroj se është qasje e vonuar.

Pyetja e dytë, është:

- A do të barten mjetet vetjake të organizatave shëndetësore buxhetore të vitit 2007 në vitin 2008 meqenëse nuk iu janë kthyer në vitin 2007...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Përgjigjet ministri i Shëndetësisë. Urdhëroni, zoti ministër!

ALUSH GASHI: Pasi që ne funksionojmë si Qeveri dhe kjo pyetje ka të bëjë edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, për të cilën e përgëzoj ish-ministrin doktor Sadik Idriz, i cili me përkushtim ka nënshkruar një memorandum me sindikatat e shëndetësisë për kthim të mjeteve vetjake. Por, siç e di ministri Sadik Idriz, nuk ka mund ta realizojë atë memorandum.

Falë mbështetjes nga Kuvendi, Presidenti por edhe Qeveria në tërësi, ne kemi arritur që këtë çështje ta ngrehim në nivel të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe për mjetet vetjake që nga 12 maj ekziston vendimi i nënshkruar për kthim të mjeteve vetjake organizatave buxhetore. Ato do të shpenzohen ashtu siç kemi biseduar këta katër muaj, si vijon:

1. Për edukim të vazhdueshëm,
2. Për përmirësim të kushteve të punës, dhe
3. Për investime kapitale.

Natyrisht, për çdo gjë, specifikimi do t'i argumentohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Arsyeja pse një herë do të vijmë në Ministri të Shëndetësisë, del nga kërkesat që i ka Ligji për shëndetësi, sepse me ligj kemi qenë shumë gjeneroz, bie fjala nuk ka të hyra në pediatri, ndërsa ata kanë nevojë për edukim permanent, për kushte të punës. Kjo ka të bëjë edhe me gjinekologji. Prandaj, ne kemi bërë një distribuim, si bie fjala: Gjilani do t'i ketë 46.000 euro, Ferizaj 28.000 euro. Kjo vlen për 3 muajt e vitit të kaluar, ndërsa për këtë vit ne kemi vendimin për të hyra të plota vetjake të cilat do të shpenzohen, siç thashë, me prioritet të përmirësimit të kushteve të punës, edukim të vazhdueshëm dhe investime kapitale. Kjo neve na shtyn në fazën e përpjekjeve që njerëzit t'i paguajmë sipas punës dhe vetë vendimi për të hyra vetjake i ka stimuluar punëtorët shëndetësorë në zyrat e pranimet dhe të emergjencës që t'i mbledhin sipas ligjit detyrimet që dalin me ligj për qytetarët e vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A doni të bëni pyetje shtesë, deputete? Faleminderit!

Deputeti Berat Luzha, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti. Ministri nuk është këtu. Doni ta bëni pyetjen, zoti deputet? Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Zoti Kryetar, unë kam dashur ta pyes ministrin për gjendjen e sigurisë në zonën e Debëldes dhe kur e ka ndërmend ta vizitojë këtë zonë, për shkak se gjendja atje është shumë e ndjeshme. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Driton Tali, pyetje për Kryeministrin. Nëse jo për Kryeministrin, ka thënë për zëvendëskryeministrin ose ministren e Energjisë dhe të Minierave, Justina Pula.

Zoti deputet, doni ta parashtroni pyetjen? Fjalën e ka deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Patjetër, zoti Kryetar, për shkak se kjo pyetje është që një muaj e gjysmë dhe po sillet, e më është dashur disa herë ta përsëris. Kam përshtypjen se ministresha qëllimisht i ikën kësaj përgjigjeje.

Sidoqoftë, të nderuar të pranishëm, kohë më parë, Qeveria propozoi ngritjen e çmimit të energjisë elektrike në vend ngase, siç dihet, çmimi i energjisë elektrike është rritur. Sipas disa të dhënave, KEK-u importon rrymë elektrike me çmim edhe mbi 100 euro për megavat.

Pyetja:

- Deri kur disa korporatave rryma do t'iu shitet me çmim të ulët, duke i shkaktuar humbje kolosale KEK-ut, si bie fjala Feronikelit rryma i shitet me 32 euro për megavat, kur dihet se konsumatorët paguajnë çmim disa herë më të lartë, si për shembull bizneset e tjera paguajnë çmim rreth 120% më të lartë, saktësisht 78.6 euro për megavat.

Andaj, unë pyes se deri kur konsumatorët dhe tatimpaguesit kosovarë do t'ia paguajnë apo falin Feronikelit – Alferonit dhjetëra milion euro në vit. Sipas llogarive, vetëm vitin e kaluar, Feronikeli, kjo korporatë profitabile i shkaktoi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, për njoftim, pyetja është bërë më 29 prill 2008. Faleminderit!

(Reagim – nuk dëgjohet për transkriptim)

Mirë. Faleminderit! E ka fjalën zëvendëskryeministri, zoti Kuçi, do të përgjigjet.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Tali! Zakonisht kjo pyetje pak më e detajizuar, por jemi të njoftuar si Qeveri. Ekziston një marrëveshje në mes të KEK-ut dhe Feronikelit, por edhe me Shar-Cem-in për një furnizim, do të thosha të plotë – 24 orë, por edhe për çmim, i cili është në kundërshtim me ekonominë e lirë të tregut. Ne jemi në fazën e negocimit, ngase nuk dëshirojmë që ta prishim marrëveshjen në mënyrë të njëanshme dhe në anën tjetër të japim një përshtypje të keqe për investitorët e huaj. Ne jemi në negociim dhe së shpejti do të marrim vendim.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Tali, doni të bëni pyetje shtesë? Fjala është për deputetin Driton Tali.

DRITON TALI: Po, unë, nuk e përfundova. Tash e tutje, 40 milion euro do t'i kushtojë Feronikeli Kosovës. Sa për informim, borxhi i kosovarëve është rreth 340 milion euro që i bie për vit 37.7 euro, domethënë Feronikeli do t'i kushtojë 2.3 milion më shumë sesa borxhi i kosovarëve. Mund ta pyetni edhe zotin Ahmet Shala, që ka qenë i involvuar në

mënyrë direkte kur është falë Feronikeli, si zëvendësdyrjtor i AKM dhe i di shumë mirë kushtet e faljes së Feronikelit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka zëvendëskryeministri, zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Mendoj se ne jemi Qeveri e përgjegjshme dhe çdo shtet të përgjegjshëm bën kontratë dhe atë në mënyrë të njëanshme nuk mund ta shkëpus, sepse kontrata ka edhe pasoja juridike. Besoj se këtë e dimë të gjithë. Ne do ta negociojmë dhe do ta shikojmë mënyrë më të mirë të mundshme që ata të mos na vënë në gjyq dhe po ashtu të mos krijojmë përshtypje të keqe, sepse investitorët e huaj në Kosovë fillimisht i stimulojmë e pastaj bëjmë veprime të njëanshme.

Në anën tjetër, sa i përket privatizimit, besoj se ka shkuar në procedura legale. Nëse ka diçka tjetër, besoj se është vendi diku tjetër që duhet këtë ta thoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Respekt deputet.

Deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Në njërën nga seancat e kaluara, na keni njoftuar se keni licencuar një numër të madh të klinikave dhe ordinancave private. Një gjë të tillë e konsideroj pozitive, mirëpo, në një aspekt puna edhe në spital, edhe në ordianca, mendoj se nuk duhet lejuar, duke marrë parasysh konfliktin e interesave.

E dimë që shumë mjek punojnë në institucione shëndetësore, por në të njëjtën kohë kanë edhe klinika private, gjë që ndikon në shkapërderdhjen e pacientëve.

- Çka do të bëni ju në këtë drejtim?

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, ministër!

ALUSH GASHI: Ju faleminderit për pyetjen! Unë këtë nuk e kam marrë, por duke ditur se është një prej çështjeve me të cilat Ministria e Shëndetësisë është marrë me të në kontinuitet, sepse është obligim i cili del nga Ligji për shëndetësi, që është miratuar në Kuvendin e Kosovës, në vitin 2004.

Zonja deputete, në Ligjin për shëndetësi të vendit tonë, mjekësia ndahet në mjekësinë publike dhe në mjekësinë private. Me ligj, i lejohet punëtorit, i cili shërben në mjekësinë publike që me gjysmë orari ta ketë punën në mjekësinë private. Ky ligj është në fuqi. Mendoj se Kuvendi, në çdo kohë që vlerëson, mund të bëjë ndryshe, por Kuvendi do t'i ketë parasysh mundësitë reale të vendit tonë. Fjala vjen, sikur ne të vepronim ashtu siç thoni ju, ne atëherë do ta vëmë në pikëpyetje tërë sistemin ndoshta publik, sepse një numër i madh i ekspertëve të cilët punojnë në institucione publike kishin për të kaluar në institucione private dhe institucionet publike kishin për të mbetur përnjëherë pa një numër i cili, sot për sot, është i domosdoshëm, në veçanti kur në vendin tonë ne edhe kemi mjekësinë terciare, siç është Qendra Klinike Universitare dhe Fakulteti i Mjekësisë. Ka ide të tilla, siç thoni ju, sepse njerëzit janë të lodhur dhe për disa raste kanë të drejtë, bie fjala, është e tepërt siç ndodh, për shembull, që drejtori i Qendrës Klinike

Universitare të Kosovës është drejtor edhe i një klinike private të veten, por atij, ligji nuk ia ndalon atë dhe ai mund t'i ketë që të dyja. Ajo çka ne mund të bëjmë si Ministri e Shëndetësisë, përmes inspeksionit, Inspektorati Sanitar dhe Shëndetësor Qendrën Klinike Universitare e monitoron për çdo ditë dhe çdo ditë në fund të orarit në orën 17 e kemi një raport për ta dhe kemi kërkuar që numri i inspektorëve për mbikëqyrje të punës sanitare dhe shëndetësore në institucione private të rritet dhe besoj se gjatë muajit të ardhshëm do të përfundojnë proceset e rritjes së këtij numri edhe në sistemin privat. Licencimin, të cilin Ministria e Shëndetësisë e ka filluar edhe më herët – në vitin 2006-2007, mund të them se sa i përket këtij procesi ne jemi shumë mirë, në krahasim me rajon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, keni pyetje shtesë? Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: A e dini numrin e mjekëve të cilët kanë ordianca private dhe njëkohësisht punojnë në spital?

KRYETARI: Ministër, a mund të përgjigjeni?

ALUSH GASHI: Unë, këtë pyetje nuk e kam të ditur për t'ua sjellë numrin e saktë, por numrin e saktë mund t'ua sigurojë brenda dite, sepse e kemi një administratë të shkëlqyeshme sa i përket licencimit. Dhe, sa i përket licencimit, ekipi që e udhëheq zotëri Bajrami, është shumë efikas dhe nuk ka ditë që nuk bëhet licencimi. Nuk ka proces të zvarritjes për licencim. E di që janë në pritje 87 që s'i kanë plotësuar kushtet për t'u licencuar si ordianca private, e tjera, por kjo punë shkon fort mirë dhe për këtë punë e përgëzoj ish-ministrin Sadik Idriz që e ka shty e të jetë në binar kaq mirë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Suzan Novobërdaliu, pyetje për ministrin e Mjedisit dhe Planifikimin Hapësinor, Mahir Jagcillar. Ai mungon.

A doni ta lexoni pyetjen, deputete?
E ka fjalën deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar! Këtë pyetje do ta lë për seancën e radhës.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi.

Doni ta bëni pyetjen deputete? Përgjigjen mund ta japë zëvendëskryeministri. Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Qeveria aktuale, që nga fillimi i punës ka ndërmarrë masa dhe veprime për marrjen nën kontroll të ndërmarrjeve publike, të cilat kanë të hyra të mëdha, si për shembull Aeroporti, PTK-ja, KEK-u dhe si rezultat i ndërmarrjes së këtyre masave, për pasojë do të kemi lëvizshmëri të kuadrove e që nënkupton hapje të vendeve të lira të punës.

Me pranimin e punëtorëve të rinj, a do të merret parasysh përgatitja profesionale dhe përvoja e punës, apo, si kriter, në praktikë do të aplikoni pranimin e anëtarëve të PDK-së?

KRYETARI: Fjalën e ka zoti zëvendëskryeministër.

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zonja deputete!

Mendoj se keni ngritur një ndër problemet që janë shumë me rëndësi në Kosovë dhe shpeshherë jep imazh të mirë ose të keqeverisjes në Kosovë. Ndërmarrjet publike në Kosovë me siguri që s'i kanë dhënë imazh shumë të mirë menaxhimit apo mentalitetit menaxhues në Kosovë dhe këtu kemi pasur telashe. Kështu është për faktin se ne nuk kemi pasur kompetenca, as kjo, as qeveritë paraprake, por e dimë se ato janë nën UNMIK, respektivisht nën autoritetin apo AKM-në. Ne kemi marrë masa që t'i dërgojmë anëtarët e Bordit dhe keni vërejtur se shumica prej tyre janë profesionist. Kemi marrë edhe një masë shumë konkrete, që të mos jenë ministrat, për shkak të ndikimit politik. Pra, kemi bërë një padrejtësi ndaj ministrave adekuat, por pas 15 qershorit ndërmarrjet publike do të kalojnë në kompetencë të Kuvendit të Kosovës dhe përmes ligjit në Qeverinë e Kosovës.

Puna e parë e jona do të jetë ndryshimi i mentalitetit qeverisës në ato ndërmarrje dhe puna e dytë do të jetë ta ndryshojmë...konsumuese të buxhetit të Kosovës, të jenë kontribuuese. Me siguri, në periudhat e ardhshme disa prej tyre do të privatizohet, disa prej tyre do të jepen me koncesion, apo ndonjëra prej tyre do të jetë shoqëria aksionare me pjesëmarrje të shtetit.

Ndërsa, sa i përket punësimit, ne jemi të thirrur në atë, jemi të obliguar që përmes konkursit të bëhet një gjë të tillë. Konkursi do të jetë transparent, do të jetë në mënyrë të hapur. Po bëj pak shaka për ata që po reagojnë, nuk kanë mbetur shumë vende për t'i punësuar më, se i kanë punësuar më herët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për Kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Doni ta lexoni pyetjen, zoti deputet? Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar! Unë besoj që zëvendëskryeministri do të mund të përgjigjet në këtë pyetje.

Kohë më parë Qeveria mori vendim për ngritjen e pensioneve nga 40 në 75 € të gjithë atyre që sjellin dëshmi se kanë dhënë kontributet përmbi 15 vjet punë. Nga mbi 35 mijë kontributdhënës vetëm 50% prej tyre, do me thënë, rreth 15 mijë janë duke shfrytëzuar këtë mundësi. Kjo është për faktin se dokumentet që kërkohen për të dëshmuar kontributdhënien është e pamundur të sigurohen nga ky 50% tjetër edhe pse dokumentet e tjera që sjellin dëshmojnë për stazhin e punës së tyre edhe mbi 40 vjet. Dihet se në sistemin e kaluar nuk ke mundur të punosh 40 vjet e të mos japësh kontributet. Pyetja ime është: Si do ta zgjidh Qeveria këtë çështje?

KRYETARI: Faleminderit! Zëvendëskryeministër, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti Makolli! Ky një prej problemeve që e kemi theksuar edhe më herët edhe në Kuvendin e Kosovës, por edhe si qeveri. Ne jemi të ballafaquar me këtë problem, mund të themi që edhe këta 15 mijë të cilët janë më herët, ka dilema, nuk duhet të dyshojmë në ta, por ka dilema që evidenca nuk është shumë e saktë. Arsyeja kryesore është se ne nuk kemi siguri të vërtetimit të atyre dokumentacioneve që kërkohet. Ne kemi kërkuar dhe do të kërkojmë në ndonjë bisedë eventuale për ndonjë dokumentacion nga ata që i kanë marrë dokumentacionin, kemi marrë edhe disa hapa shtesë. Po e zëmë, dje në Qeverinë e Kosovës kemi marrë iniciativë që gjithë punëtorëve të arsimit t'u njihet stazhi nga viti 1990, respektivisht 1991 deri më 1999 dhe besoj se këtui zgjidhet problemi i një numri të caktuar të njerëzve, jo i të gjithëve. Veprime të tilla do të marrim edhe me punëtorët e shëndetësisë dhe me të tjerët. Është një problem se disa kanë vërtetuar që kanë marrëdhënie të punës, po e zëmë, deri më 1990, me 14 vjet e 11 muaj, që ne duhet ta bëjmë një zgjidhje legale. Kjo ka implikime buxhetore dhe duhet të bëhet përmes vendimit që e merr Kuvendi i Kosovës dhe përmes ndarjeve buxhetore. Vërtetimi momentalisht mund të jetë hipotekar, do ta quaja, por jo në kuptimin e realitetit.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti deputet, keni pyetje shtesë. Fjala e deputetit Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit!

Po ripërsëris edhe një herë. Ka njerëz të cilët kanë punuar 40 vjet, ndërkaq nuk mund ta dëshmojnë, sepse në sistemin e kaluar shumë herë nuk kanë lejuar dokumente të tilla, ndërkaq të gjithë ne e dimë që në sistemin e kaluar nuk ke mundur të punosh, të jesh në marrëdhënie të punës dhe të mos ndalen kontributet.

KRYETARI: Faleminderit! Zëvendëskryeministër, e ke fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ne, zoti Makolli, e dimë këtë dhe jemi të vetëdijshëm të gjithë. Në institucione punohet me dëshmi, me letra, me fakte. Do të thotë, nuk mundemi vetëm mbi bazën e hipotezës se i ka paguar kontributet dhe ne ta bëjmë një veprim të tillë. Do ta bëjmë një mundësi legale, por gjithmonë e legalizuar dhe e legjitimuar nga Kuvendi.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje në vazhdim, deputetja Qamile Morina, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mjekimi intensiv qendror i Qendrës Klinike Universitare është e vetmja qendër referente në Kosovë dhe është e rëndësisë shtetërore. Kapacitetet e mjekimit intensiv qendror janë shumë të limituara karshi nevojave dhe kërkesave të pacientëve që luftojnë për jetë. Andaj, në vitin 2007 është bërë projekti për zgjerimin dhe renovimin e kësaj njësie. Nga buxheti janë alokuar 220 mijë euro në mars të vitit 2007, kurse kontrata për renovim është bërë më 17 korrik 2007. Të hollat prej kodit për këtë projekt janë paguar në vlerë prej 63 mijë eurove. Gjer më tani nuk është realizuar asgjë nga ky projekt. Zoti ministër, a do të realizohet ky projekt dhe kur?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, mund të përgjigjesh.

MINISTRI ALUSH GASHI: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,

Si edhe pyetjen e mëparshme, as këtë nuk e kam marrë nga administrata, por është një çështje me të cilën jemi marrë me vazhdimësi dhe më lejoni t'ju përgjigjem.

Ministria e Shëndetësisë e ka mbështetur në plotëni dhe i ka ndarë mjetet sipas kërkesës së Qendrës Klinike Universitare për zgjerim dhe renovim të emergjencës. Mjetet janë në Qendrën Klinike Universitare dhe është zotimi i ministrit për mosndërhyrje në menaxhim të Qendrës Klinike Universitare, është kompetencë e tyre. Katër herë kam qenë në vizitë vetëm për vizitë Qendrës së Emergjencës si zgjidhje tranzitore. Hapësirën që keni kërkuar të rinovohet, është e pamjaftueshme. Angazhimi im është që në Konferencë të donatorëve ta afrojmë projektin sipas master planit për ndërtim të objektit, në të cilën do të jetë intensiva qendrore me emergjencë dhe sallat e operacioneve të Qendrës Klinike Universitare. Zgjidhja të cilën e keni kërkuar ju, është vetëm emergjente, është tranzitore dhe çka do që të veprohet në atë drejtim, është vetëm e përkohshme. Në vizitën e fundit me Kryeministrin në Qendrën Klinike Universitare kemi kërkuar që udhëheqja e Qendrës Klinike Universitare ta zbatojë projektin, të cilin e ka kërkuar vetë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Por, vërtet, kontrolloni administratën ku i kanë lënë pyetjet. A ka pyetje shtesë? Fjala e deputetes Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Po, sipas Ligjit të shëndetësisë, Qendra Klinike Universitare i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Ministria e Shëndetësisë dhe ajo duhet të mbikëqyrë punët që ndodhin në Qendrën Klinike Universitare. Unë gjithashtu kuptoj angazhimin e juaj në drejtim të zgjidhjes së këtij problemi. Mirëpo, unë dua t'ju rikujtoj se ne jemi shumë të vonuar në zgjidhjen e këtij problemi me qenë se tashmë 3 vite radhazi ekziston projekti për zgjerimin dhe renovimin e mjekimit intensiv, i cili është tejet jetik edhe vital për Qendrën Klinike Universitare dhe për shtetin e Kosovës. Andaj, komoditeti se si ne po i qasemi zgjidhjes së këtij problemi, unë mendoj që kjo shkon drejtpërdrejt në dëm të pacientëve. Kështu që pyetja ime do të jetë: Për mos realizimin e këtij projekti...?

(Ndërprerje e incizimit)

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit! Pajtohem që spitalet dhe mjekësia terciare është në mbikëqyrje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe atë mbikëqyrje e bëjmë në baza ditore, por ministri i Shëndetësisë nuk është menaxher i Qendrës Klinike Universitare dhe për menaxhimin e dobët të Qendrës Klinike Universitare ne kemi dhënë vërejte, kemi marrë masa në emergjencë ku ju punoni. Në Intensive është dëshmia nga Instituti Kombëtar i shëndetësisë publike për mosmbajtje të higjienës, për mosfurnizim me kohë. Në kohën kur ju ankoheni që nuk ka mantele, nuk ka dorëza, në Mazgit, si dhe në qendrën kryesore, në barnatoren qendrore, ka me mija, do të thotë që është problemi i menaxhimit dhe këtë problem ne do ta zgjidhim. Por, sa i përket renovimit, mjetet janë, projekti është, është në kompetencë të QKUK-së dhe nëse ata nuk e ekzekutojnë këtë vendim, sipas ligjit do të veprohet.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit!

Zoti Kryetar, mosprezencën e Kryeministrit e kuptoj si injorim ndaj Kuvendit dhe mosinteresim për problemet e jetës së qytetarëve. Prandaj, kërkoj që të shfrytëzoni

autoritetin Tuaj që Kryeministri të jetë këtu dhe t'i përgjigjet pyetjes. Dhe, gjithashtu, ju lutem komunikoni mes veti se ministri Gashi që sa herë thotë se nuk e ka marrë pyetjen. Prandaj, pyetjen do t'ia shtroj Kryeministrit në seancën e ardhshme, duke ju sugjeruar edhe njëherë që ju të shfrytëzoni autoritetin që keni dhe ta mbani Qeverinë të përgjegjshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po ju tregoj që pyetjet që bëhen nga deputetët, Administrata e Kuvendit i procedon në ministrinë përkatëse. Është çështje e administratës së ministrive, ku dhe si i trajtojnë pyetjet e deputetëve. Do të thotë, Administrata e Kuvendit e ka kryer detyrën dhe obligimin e saj.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Ministri nuk është këtu. A doni ta lexoni pyetjen, zonja deputete? Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit! Do ta pres ministrin e Ekonomisë dhe të Financave në seancën e radhës që të më përgjigjet në pyetjet e mia. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Hajdin Abazi, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN BAZI: Duke përgëzuar ministrin për punën që ka bërë në hapjen e shkollave të reja, renovimin dhe fillimin e kompjuterizimit të tyre, në këtë vazhde ai ka ndërmarrë me një procedurë të përshpejtuar dhe çështjen e licencimit të mësimeve. Pyetja ime dhe të bëjë me atë se çfarë do të sjellë ky licencim për mësime, më konkretisht, a do të sjellë ndonjë përmirësim të të ardhurave të tyre dhe, nëse po, si?

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuari zoti Kryetar,
Të nderuar kolegë ministra, deputetë,

Mendoj se një pyetje e tillë është qenësore sidomos për arsimin parauniversitar. Procesi i licencimit nënkupton që të sigurohet në bazë se si ndodhë reforma e pagave, përveç aspekteve të tjera profesionale, dhe se si të krijohet mundësia që arsimtarët të trajtohen si shërbim profesional në çdo shoqëri. Në asnjë formë nuk nënkupton që arsimtarët mund ta humbin vendin e punës ose do të rrezikohet puna e tyre më tërësisht, mirëpo synon thjeshtë që çdo arsimtarë ta pajisë me një licencë. Puna e cila është bërë deri më tash, do të synoj që ta informoj Kuvendin për këtë punë në vija të përgjithshme. E para, është riorganizuar grupi punues, kemi hartuar një platformë të detajuar për procesin e licencimit dhe kemi një plan të punës në fazë, i cili parasheh se si të ndodhë procesi i licencimit të arsimtarëve. Ju e dini që ne kemi në Kosovë 27 mijë arsimtarë deri më tash dhe në fazën e parë parashihet që gjatë 2-3 muajve të ardhshëm të pajiset çdo arsimtarë në Kosovë me një licencë, e cila do të lëshohet në përputhje me përvojën e punës, do të thotë se sa gjatë ka punuar në një institucion shkollor dhe me shkallën e përgatitjes profesionale që ka ai arsimtar, pavarësisht prej asaj a ka ndonjë shkollë të lartë, ndonjë fakultet ose ndonjë titull shkencor ose edhe të tillë të cilët nuk janë edhe të kualifikuar. Ne parashohim që deri në muajin shtator ky proces do ta përfshijë tërë kolektivitetin e arsimtarëve, përndryshe në fazën e dytë, e cila parashihet që të zgjatë deri në vitin 2011,

kriter nuk do të jetë vetëm përvoja e punës dhe kualifikimi i arsimtarëve, por kriter do të jetë performansa, përkushtimi i arsimtarëve në procesin mësimor, se sa ata thjeshtë janë të përkushtuar në procesin mësimor. Ne ende nuk e kemi një përgjigje të saktë se cili është arsimtari në klasë sot, çfarë pune bën arsimtari. Prandaj, do të bëjmë përpjekje që deri në vitin 2011, përmes monitorimit të sistemit tonë parauniversitar ta definojmë qartë se çfarë ndodhë në shkollë.

Në fazën e tretë parashihet që të ketë mandej edhe programe të mirëfillta trajnuese, të akredituara dhe të licencuara nga Këshilli Kombëtar për Licencim dhe Akreditim, i cili kështu do të merret kryesisht me arsimin para universitar dhe jam shumë i sigurt që deri në vitin 2010-2011 arsimtarët në Kosovë do të jenë të krahasueshëm, të matshëm edhe me arsimtarët në Evropë, meqë në ditët e sotshme, thjeshtë pozita e tyre është pothuajse e vështirë që të maten me të tjerët në Evropë. Do të thotë, përveç efektit të parë që do ketë që Kosova duhet ta tejkalojë sistemin e pagave lineare, atë sistem të rrafshët të pagave lineare, i cili ka hyrë në përdorim në Kosovë pas...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Faleminderit! Kjo ishte pyetja dhe përgjigja e fundit për seancën e sotshme, e kemi harxhuar kohën. Seancës së ardhshme i mbesin 10 pyetje që mbesin nga kjo seancë, plus ato të tjerat.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyje

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin, në parim, të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Titulli i Projektligjit është “për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 2003/3 për pyjet e Kosovës”.

Fushëveprimtaria e këtij Projektligji është objektiva, masa dhe programi i politikave të pylltarisë dhe të zhvillimit rural, shërbimet në pylltari si dhe baza e të dhënave dhe informacioneve për politikën e ruajtjes, të mbrojtjes dhe të zhvillimit të pylltarisë.

Arsyetimi për Projektligjin: Alternativa e rekomanduar është nxjerrja e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës. Përveç kësaj, kjo ndërmarrje legislative do të ishte në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe të drejtësisë në programin e politikave të zhvillimit, të ruajtjes dhe të mbrojtjes së pylltarisë e të zhvillimit rural, të shërbimeve në pylltari, të kërkimit dhe të sigurimit profesional, si dhe të bazës së të dhënave dhe të informacioneve për politikën në pylltari.

Propozuesi, gjithashtu, konsideron si të nevojshme rregullimin e formave të organizimit të prodhuesve, të përpunuesve dhe të tregtarëve të druve dhe të produkteve drunore.

Qëllimi i projektligjit: Qëllimi i këtij Projektligji është që të rregullojë çështjet të cilat janë të rëndësishme dhe me prioritet për mbrojtjen e pyjeve të Kosovës, për të siguruar koherencë dhe legjislacion për Ligjin për pyjet e Kosovës.

Ndryshimi dhe plotësimi duhet të bëhet për shkak të asaj se Ligji për pyjet e Kosovës nuk ka gjetur zbatueshmëri të plotë për shkak të mangësive që kanë ekzistuar për një zhvillim të qëndrueshëm të pylltarisë.

Përmbajtja e Projektligjit: Ndryshimi dhe plotësimi i Projektligjit përmban 5 nene, të cilat kanë të bëjnë me rekomandimet që i bën Agjencia Pyjore e Kosovës për çështjet e përgjithshme që ndërlidhen me pyjet dhe pylltarinë dhe shqiptimin e masave ndëshkimore.

Zbatimi i këtij Projektligji nuk do të ketë implikime buxhetore dhe hartimi i Projektligjit është në pajtim me nenin 36 të Rregullores së Punës të Qeverisë.

Ky Projektligj ka edhe deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, të lëshuar me datën 21.03.2008.

Kërkoj nga deputetët që, në parim, të përkrahin këtë Projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas prezantimit, hapim debatin. Sipas radhës, kryetari ose raportuesi i komisionit funksional. Fjalën e ka kërkuar zoti Lulzim Zeneli. E keni fjalën!

LULZIM ZENELI: Zoti Kryetar, faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Në emër të Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, flas pas një takimi që kemi mbajtur dhe kemi vlerësuar se ky Ligj as për së afërmi nuk i plotëson kërkesat që nevojiten dhe janë aq imediate për ndryshim përmbajtjesor të Ligjit aktual për pyje. Prandaj, duke u nisur nga gjendja aktuale që është mjaft shqetësuese si rezultat i dëmtimeve masive që po ngjajnë çdo ditë në këtë sferë të ekonomisë, duke u nisur nga ajo që ekziston në memorandumin shpjegues sa i përket këtij Projektligji dhe duke u nisur nga nevoja për një qasje krejt ndryshe në raport me këtë sferë, por edhe njëkohësisht duke iu referuar obligimeve që rrjedhin nga plani i Presidentit Ahtisari për decentralizim të kësaj fushe, Grupi apo Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis sugjeron dhe del me qëndrim në seancë plenare që Qeveria në këtë rast të tërhiqet nga ky Projekt apo Kuvendi i Kosovës ta kthejë mbrapa këtë projektligj për arsye se ky ligj apo ky projektligj nuk garanton dhe nuk reflekton asnjë sinjal për të ndryshuar gjendjen aktuale që ekziston në këtë sferë.

Njëkohësisht, këtë që e them tash, reflekton edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Në emër të Grupit, deputeti Berat Luzha.

BERAT LUZHA: Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mendon se ky Projektligj nuk i plotëson nevojat për normimin adekuat të gjendjes në pylltari. Prandaj, mendojmë se duhet ta kthejmë këtë Projektligj dhe i rekomandojmë Ministrisë që të fillojë nxjerrjen e një ligji të ri, ku do të inkorporohen edhe çështjet që janë në planin e Ahtisarit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural kanë marrë pjesë në punën e Komisionit në të cilën është shqyrtuar Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet dhe ka marrë vendimin që ky Projektligj të tërhiqet prej procedurës për arsye se nuk janë bërë ndryshime të mjaftueshme për mbrojtjen e pyjeve. Prandaj, duhet të bëhen ndryshime përmbajtësore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Me radhë, Grupi Parlamentar i AKR-së, deputeti Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës nr. 2003/3 është hartuar për shkak të mangësive që janë vërejtur gjatë implementimit të këtij Ligji.

Ky Projektligj është hartuar me 5 nene, ku janë dhënë disa propozime dhe sugjerime të cilat nuk garantojnë një implementim të mirëfilltë.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar mendojmë se edhe me plotësimet e Ligjit 2003/3 me propozimet e bëra nuk garantohet se Ligji në fjalë do të implementohet në praktikë për shkak të mangësive të tjera. Projektligji duhet t'i kthehet Qeverisë, respektivisht sponzoruesit me qëllim të ndryshimit përmbajtësor dhe substancial me qëllim të aplikimit sa më të mirë në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, grupi Parlamentar i AAK-së. Për fjalë është lajmëruar deputeti Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar qeveritarë, kolegë deputetë,

Bëhet fjalë për një Projektligj që është shumë me rëndësi dhe është shumë jetik për Kosovën, dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës iu bashkëngjitet kolegëve paraprakisht. Por, kemi një shqetësim sa i përket sponzoruesit të projektligjit dhe para nesh paraqitet një dyshim se a është sponzorues Agjencioni i Pyjeve i Kosovës apo është Ministria e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural. Një e vërtetë e madhe që sot po ngjjet në Kosovë është dëmtimi enorm i pyjeve në Kosovë dhe ne, si Grup Parlamentar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon që sponzoruesi i ligjit, në këtë radhë ministri, të marrë hapa konkret dhe me një dekret të veçantë të ndalojë prerjen e pyjeve në Kosovë, që Agjencioni kosovar i Pyjeve të mos ketë mandatin dhe planifikimin e shfrytëzimit të pyjeve. Kosova ka nevojë për mbrojtje dhe, ne si deputetë, kërkojmë që

herëve të tjera Qeveria e Kosovës të jetë më e kujdesshme, të jetë më serioze dhe para nesh të ofrojë ligj, i cili do të hyjë në punë dhe ligj i cili do të hapë perspektivë. Kërkojmë që ky ligj të kthehet prapa. Faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Sipas radhës, Grupi Parlamentar “7+”, deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zoti Kryetar!
Zotëri ministra, zonja e zotëri deputetë,

Edhe Grupi “7+” pajtohet me parafolësit se Komisioni për Bujqësi e ka sjellë një ligj që ende nuk është i kryer. Le ta kryej Ministria e Pylltarisë, atëherë le të sjellë edhe një herë në Kuvend.

KRYETARI: Faleminderit! Sipas radhës, Grupi Parlamentar i SLS-së, deputetja Kosara Nikolić.

KOSARA NIKOLIĆ: Parlamentarna Grupa SLS je u svemu saglasna da se ovaj zakon povuče.

KRYETARI: Faleminderit!
Tani janë në radhë deputetët. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Përshëndetje zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë të gjitha grupet parlamentare tani u pajtuan që ky Projektligj nuk i plotëson as për së afërmi ndryshimet të cilat duhet të bëhen në këtë ligj, unë vetëm po i prek disa çështje që nuk janë përfshirë fare. Këtu janë vetëm 5 nene, të cilat me një farë mënyre nuk kanë plotësuar dhe nuk e bëjnë të implementueshëm ligjin, sepse nuk është prekur përmbajtja e Projektligjit, e cila kërkon çështje të tjera, të ngrihet në çështjen e menaxhimit, në çështjen e kompetencave të autoriteteve të cilat do të menaxhojnë me pyjet, por edhe aspektin e gjuhës juridike që e kanë përdorur. Është shumë interesat se vetëm në preambulë thirren në dispozitat përfundimtare, 9.1, 45 janë dispozitat përfundimtare. Kurse, në dispozitat përfundimtare thirren në dy institucione të cilat e shtyjnë ligjin në fuqi. Duhet të kenë kujdes. Shkruan: “Ky ligj hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga kryetari i Kuvendit”, e më pastaj thotë: “pas shpalljes së Presidentit apo të Kryetarit të Kosovës”. Prandaj, me gjithë të drejtë kërkohet që ky Projektligj të kthehet mbrapa dhe që bëhen ndryshime më rrënjësore. Faleminderit.

Kryetari: Faleminderit!
Për fjalë është lajmëruar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zoti kryetar,
Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Fillimisht e mbështes kolegun e nderuar Bahri Hyseni, në ato theksime dhe do të kisha shtuar edhe diçka tjetër, me qëllim të kontribuimit që të përgatitet një projektligji shumë më serioz.

Ne e dimë fare mirë në praktikat aktuale se në përmishten e vet, në përmishte se jo në pyll të themi që është pronë private, e supozohet se aty pronë private, është e pacenueshme, e paprekshme etj. me autorizime absolute që nuk mund ta pres në vendet përfundimtare një pemë apo një dru pa leje edhe leja jepet vetëm kur druri është në degradim e sipër. Prerja e një, dy druve, bartja e atyre druve apo e drurit të prerë në pjesë, mund të bëhet prapë me lejen për bartje po që se e ka mbjellë aty fidanin dhe ka pasur sukses. Prandaj, këto pika do të isha angazhuar që të inkorporohen në Projektligjin për pyjet.

Këto shprehje, ju lutem, janë të patolerueshme. “Gjyqi dënon personin me gjobë për kundërvajtje”, jo gjyqi, por gjykata, dënon me të holla, e jo me gjobë, apo jo? Pyllëzimi duhet të inkorporohet në këtë projekt, pyllëzimi i fushave djerrina që janë pasojë e prerjeve të pamëshirshme dhe të pa plan edhe tepër dëmtuese. Do të thotë, do të duhej kaptinë e posaçme për pyllëzim të fushave, të cilat janë të përshtatshme për pyllëzim, për mbrojtjen, për kultivimin dhe përparimin e pyjeve tona.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Elhame Hetemi.

ELHAME HETEMI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,
Ministre e ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji aktual për pyjet që ka qenë në fuqi, pajtohem se nuk ka pasur një bazë ligjore të përshtatshme për mbrojtjen e këtij dikasteri aq të rëndësishëm, jo vetëm të rëndësisë ekonomike, por edhe të rëndësisë ekologjike.

Pajtohem edhe me faktin tjetër se nuk ka pasur një qasje serioze, sepse problemet rreth mbrojtjes dhe kujdesit ndaj pyjeve, nuk janë vetëm probleme që janë sot, por janë probleme në vazhdimësi, prandaj, mund të them se nuk ka pasur një qasje serioze prej Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural për këtë fushë të rëndësishme.

Për të krijuar një bazë më të përshtatshme ligjore, unë mendoj se ky projektligj duhet të tërhiqet, jo vetëm me plotësime, por duhet të tërhiqet në tërësi dhe të krijohet, të hartohet një projektligj që do të kishte një bazë ligjore shumë më të përshtatshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e pylltarisë.

Ajo çka është tani e rëndësishme, mendoj se derisa të miratohet për ta plotësuar këtë vakum të bazës ligjore rreth mbrojtjes së pyjeve, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, duhet të ketë një kujdes më të madh në këtë kohë rreth mbrojtjes dhe ripyllëzimit të pyjeve.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Zoti ministër, si sponsor, vërejtjet i dëgjuat. Asnjë grup parlamentar nuk e mbështet votimin në parim dhe kërkuan tërheqjen e tij. Keni ju koment? Po, urdhëro!

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Besoj se që të gjithë jemi të vetëdijshëm se si shënohen, shkruhen ose projektohen këto ligje në Kosovë, domethënë ne nuk kemi shpikur asgjë aty. Sigurisht se edhe ky projektligj është i bazuar në ligjet edhe të rajonit, edhe të BE-së, sepse për këtë ne e kemi edhe deklaratën e pajtueshmërisë dhe për atë se nuk ka mundësi të ruhen pyjet më shumë nuk është faktor projektligji dhe besoj se këtë të gjithë e dimë, sepse keqpërdorime edhe shpërfillje të ligjeve ka edhe në sektorët e tjerë. Në të gjitha fushat e jetës edhe të punës në Kosovë, ka shkelje të ligjit dhe moszbatueshmëri.

Projektligji në letër nuk ka mundësi të rregullojë asgjë edhe për këtë besoj se të gjithë e dimë. Projektligji për t'u zbatuar duhet të funksionojë shteti si një organ i tërë në të gjitha sistemet. Pyjet nuk kanë mundësi të ruhen me njerëz të thjeshtë, të rëndomtë dhe të paarmatosur, në rast se nuk i përkrahin organet tjera, duke filluar prej policisë dhe gjykatave. Prandaj, unë them më mirë një projektligj, ndoshta, jo në atë formën e plotë më të mirë të mundshme, por gjithsesi duhet të jetë dhe kjo sigurisht do të plotësohej dhe do të ndërrohej edhe me propozimin e Ahtisarit, sepse ne nuk mund të paragjykojmë sot se çka parasheh propozimi i Ahtisarit, jo vetëm për pylltari, por edhe për fushat e tjera.

Kur themi pyjet janë pasur kombëtare, atëherë komunat nuk mund të kërkojnë të gjitha kompetencat për pyjet në këtë rast, sepse në Kosovë ka edhe komuna të atilla të cilat nuk kanë pyje.

Unë prapë kërkoj, vendosni ju si Kuvend, mirëpo ju kisha përkujtuar edhe njëherë se projektligjet ose ligjet nuk kanë faj pse nuk zbatohen deri në fund, faj është diku tjetër. Ju Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në vazhdim kërkoj që të deklarohejmë për miratimin në parim të këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

A ka deputetë që nuk kanë kartela? Një. Votoni ” për “ ose “kundër”. Mirë. Ju faleminderit.

Ju njoftoj se në sallë janë prezentë 66 deputetë.

Me 10 vota “për”, 41 “kundër” dhe 7 abstenime, konstatoj se Ligji nuk miratohet në parim dhe i kthehet Qeverisë për ripunim.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare

Në bazë të Rregullës 35, pika 1 të Rregullores së Punës, janë plotësuar kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftojme ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxha, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

ENVER HOXHAI: I nderuari zoti Kryetar,
I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në vija shumë të përgjithshme ta prezantoj një projektligj të tillë, i cili definitivisht për sistemin tonë arsimor dhe për sistemin tonë të trajnimeve ose të aftësimeve paraqet një risi. Projektligji synon që ta rregullojë sistemin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe që do të rregullohet nga autoriteti kombëtar i kualifikimeve.

Çka nënkupton një cak i tillë i projektligjit në jetën tonë publike dhe arsimore? Më lejoni që në shtatë elemente kryesore, ta prezantoj shkurt. E para, edukimi dhe arsimi sot, nuk është çështje që iu referohet vetëm atyre që janë në banka shkollore, por është një fenomen kompleks, i cili i referohet dhe me të cilin ka të bëjë çdokush. Prandaj, ky ligj synon që t'i ofrojë qasje në arsim dhe në aftësim, një terminologji që po e përdorim në kohëve të fundit në trajnime, do të thotë qasje në arsim dhe në aftësim të çdokujt, në çdo moshë dhe në çdo kohë. Do ta kemi një sistem arsimor i cili nuk është në gjendje ti thotë dikujt se nuk ke të drejtë që ta ushtrosh të drejtën tënde në arsim, por do t'i hapë rrugë se si të jetësohet kjo e drejtë.

Çështja e dytë ose niveli i dytë i këtij ligji që e rregullon, është se ky ligj e ndërlidh sistemin tonë të arsimit dhe sistemin tonë të aftësimeve ose konkretisht arsimin formal dhe joformal përmes Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Me fjalë të tjera, u mundëson që njerëzit, thjeshtë, pavarësisht se çfarë grade kanë marrë, se çfarë kualifikimi kanë, përmes arsimit për të rritur, përmes mësimit gjatë tërë jetës, përmes formave të tjera të arsimit joformal në një kohe të caktuar t'i kthehen edhe sistemit të arsimit formal.

Çështja e tretë ose niveli i tretë i këtij ligji, ka të bëjë me atë që mundëson, që të njihet dhe të pranohet çdo diplomë brendapërbrenda Kosovës, çdo dëftesë brendapërbrenda Kosovës, çdo formë e kualifikimit, çdo nivel i dijes brendapërbrenda Kosovës. Përveç kësaj edhe këto diploma, ky sistem i kualifikimeve të jetë i pranueshëm dhe në të njëjtën kohë i njohur edhe në Bashkimin Evropian.

Për këtë arsye, edhe Ligji i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, i sistemit kombëtar të kualifikimeve, është në harmoni të plotë me atë që thirret European Qualification Framework, me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, një sistem ku shumica e vendeve perëndimore sot po lëvizin shpejt që ta aplikojnë.

Çështja e pestë, që desha ta ngrit është se ky ligj mundëson që thjesht të orientohet sistemi ynë arsimor dhe sistemi ynë i aftësimeve më afër nevojave të ekonomisë dhe të tregtisë. Dhe, dy çështjet e fundit që desha t'i përmendi është se Ligji si i tillë, thjesht Kosovën e bën të parën në rajon. Me miratimin e tij në Kuvendin e Kosovës, ne jemi duke lëvizur shumë më shpejt se sa vendet e tjera në sistemin e kornizës kombëtare të kualifikimeve.

Për fund, më lejoni që ta falënderoj ish-ministrin Agim Veliu për punën e shkëlqyeshme që e ka bërë që ky ligj të ofrohet në këtë formë dhe veçanërisht zotin Ramë Buja që ka qenë anëtar i Komisionit për Arsim, profesor Nimon Alimusajn, profesoreshën Sala Ahmetajn Drita Statovcin dhe Myrvete Dreshajn, të cilët kanë qëndruar disa herë në Irlandë, Estoni në vendet e ndryshme, që thjeshtë e kanë kornizën kombëtare të

kualifikimeve. Unë i falënderoj për kontributin që e kanë dhënë dhe ky ligj është në këtë formë falë kontributit të gjithë këtyre që unë i përmenda.

E lus Kuvendin e Kosovës, i nderuar zoti kryetar, që ta miratojnë këtë ligj, meqë ky ligj, jam shumë i sigurt që do t'ia mundësojë çdokujt në Kosovë që diploma e tij në një afat të caktuar kohor të njihet, të pranohet, të jetë e barasvlershme dhe të njëjtën kohë të jetë funksionale brenda Kosovës dhe brendapërbrenda Bashkimit Evropian dhe përmes Bashkimit Evropian diplomat tona mund të jenë të pranueshme dhe të njihen edhe më tutje në vendet e tjera të botës.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Edhe unë ju falënderohem juve. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, kush e do fjalën? Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Ju faleminderit zoti Kryetar,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, ka shqyrtuar në parim Projektligjin për kualifikimet kombëtare.

Më lejoni që fillimisht ta përgëzoj Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për një dokument kaq përmbajtjesor dhe në nivel shumë të lartë teknik të përgatitur.

Historiku i zhvillimit të ligjit, ka filluar në legjislacionin e kaluar, në Komisionin e Arsimit dhe është rezultat i një dialogu intensiv, reflektimit dhe procesit të planifikimit nga grupi i ashtuquajtur i Dublinit, i mbështetur materialisht nga Fondacioni Evropian për trajnime, Agjencioni Evropian për Rindërtim dhe Organizata e Sigurisë dhe e Bashkëpunimit të Evropës.

Projektligji vjen në kohën e domosdoshme dhe do të ndikojë në jetësimin e interesit kombëtar dhe shtetëror të Kosovës, kah një shoqëri e dijes dhe e konkurrencës në tregun e punës së Kosovës dhe jashtë saj, duke krijuar mekanizmat për barasvlerën e dijes me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian.

Përfituesit e këtij ligji, janë të gjithë kandidatët që marrin kualifikime si dhe punëdhënësit dhe institucionet që ofrojnë kurse që qojnë në kualifikim si dhe ekonomia, respektivisht shoqëria në përgjithësi. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve me mekanizmin e kornizës kombëtare të kualifikimeve, rregullon vlerën e dijes në arsimin formal, joformal, informal, në arsimin para universitar dhe arsimin e lartë, si dhe dokumentet e vlefshme zyrtare që shoqërohen me nivelet e arsimit.

Pikat e përbashkëta të referimit të kualifikimit në mes të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe kornizës kombëtare të kualifikimeve nëpër nivele, do të krijojnë mundësi për përfituesit e këtij ligji, të drejtën dhe barazinë e konkurrimit në tregun e punës, si brenda Kosovës, ashtu edhe jashtë. Themelimi i këtyre standardeve kombëtare të kualifikimit, që bazohet në kornizën kombëtare të kualifikimit, do të rregullohen me autoritetin kombëtar të kualifikimit, sipas Ligji, ngërthen në vete edhe implikime buxhetore të paraqitura në dozë të supozimit dhe nuk paraqesin shumë fakte reale të implikimeve buxhetore.

Më lejoni të marr një shembull: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka kërkuar dhjetë vende pune, ndërsa vlerësimi i ndikimit buxhetor ka kalkuluar me gjashtë vende të punës por, edhe në rastet tjera, për shpenzimet tjera që nuk janë kalkuluar fare, siç është shembulli te pika 9.6 që paraqet një çështje të urës lidhëse në mes të MASH-it dhe autoritetit kombëtar të kualifikimeve. Andaj, do të sugjerojmë që të përmbushen kërkesat e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mënyrë që funksionalizimi i këtij autoriteti të fillojë sa më shpejt. Projektligji, gjithashtu, ka pajtueshmërinë e legjislacionit me Bashkimin Evropian dhe krejt në fund Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës jep pëlqimin që ky projektligj të miratohet në parim dhe kontributin tonë profesional do ta ofrojmë në Komisionin Funksional të Arsimit.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radhën e ka Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Sanije Aliaj. Meqë nuk është paraqitur, fjalën e ka deputeti Agim Veliu. Pra, shtypeni elektronikën.

AGIM VELIU: Të faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah miratimin e Projektligjit për kualifikimet kombëtare në parim. Besojmë se me këtë projektligj do të krijohet sistemi i kualifikimeve kombëtare, të cilat do të jenë të bazuara në kornizën kombëtare të kualifikimeve, si mekanizëm për klasifikimin e kualifikimeve të bazuara në kriteret që përcaktojnë nivelin dhe llojin e rezultateve të mësimi në arsimin formal dhe në atë joformal.

Deputetët e Lidhjes Demokratike, sigurisht, do ta japin kontributin e tyre në procedurën e mëtejme gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, dhe po them edhe një herë se e përkrahim miratimin në parim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radhën e ka Grupi Parlamentar i AKR-së, deputeti Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Zoti Kryetar,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për kualifikimet kombëtare rregullon krijimin e sistemit kombëtar të kualifikimeve, me qëllim të përmirësimit të menjëhershëm të sistemit të arsimit dhe aftësimit në Kosovë.

Ky projektligj është hartuar sipas ligjeve të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe është i përpunuar në 8 kapituj me 25 nene, me një gjuhë mjaft të pasur juridike. Sipas përmbajtjes së ligjit, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është themeluar me mandat që të krijojë, të zbatojë dhe të mbikëqyrë sistemin e kualifikimeve kombëtare, mirëpo në projektligj duhet të saktësohen më mirë këto detyra. Ky projektligj do të ketë edhe

ndikim buxhetor në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, si në aspektin e shpenzimeve po ashtu edhe në aspektin e të hyrave.

Ne si grup parlamentar kemi edhe disa vërejtje konkrete në disa nene të projektligjit, të cilat tani nuk po i ceku, por mendoj se ne si Grup Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, pajtohemi që ky projektligj të procedohet në Komisionin Funkcional për shqyrtim të mëtutjeshëm, ndërsa ne si grup parlamentar do të angazhohemi ta japim kontributin tonë profesional gjatë shqyrtimit të projektligjit në faza tjera në vazhdim.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit Ardian Gjini, e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht po them që Ligji përfundimisht ka shumë pak gabime gjuhësore. Kjo është e fundit që Kuvendi duhet ta potencojë për një ligj, do të thotë gjuha është diçka e fundit për kah rëndësia për shkak se ka mundësi përmirësimi. Mirëpo, na ka ardhur një ligj, që realisht kur lexohet, lexohet pak edhe faleminderit ministër, faleminderit edhe për idenë e mirë edhe tuajën edhe të ish-ministrit.

Sidoqoftë, unë po filloj dhe po i lexoj pesë rreshta të Deklaratës të Agjencionit për Integritet Evropian, më vonë do të kaloj edhe te një agjencion tjetër i Kosovës, që është shumë i rëndësishëm. Shikoni çka thotë deklarata e AIE-së:

AK-ia e BE-së, është e shkruar keq, normal, si shumë dokumente të tjera. AK-ia e BE-së në fushën e edukimit dhe të kualifikimit është e gjerë, ka gabuar gjininë. Andaj, implementimi është kyç në përfundimin e sistemit sa më kualitativ të edukimit. Sa i përket Kosovës, edhe pse nuk mund të kërkohej nga ana e ligjvënësve vendor që në tërësi ta harmonizojë legjislacionin vendor me atë evropian, megjithatë është më së e rëndësishme të merren parasysh parimet kryesore horizontale të aqvis communautaire. Sipas përmbajtjes së Ligjit, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është themeluar me mandat të krijojë, të zbatojë dhe mbikëqyrë sistemin e kualifikimeve kombëtare, andaj edhe pse Projektligji për kualifikimet kombëtare nuk është drejtpërdrejtë e rregulluar me aqvis komunitare në BE, ngase përcakton obligime për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve të hartojë akte nënligjore në fushën përkatëse, është më se e rëndësishme që ligjet e ardhshme si dhe aktet tjera nënligjore të ministrave, të hartohen në përputhje me parimet e aqvis komunitare.

Nëse dikush e lexon këtë pjesë, kjo do të thotë që ky nuk është, por tjerat bëni në përputhje. Tash po them kështu, aqvis komunitare nuk është legjislacion i BE-së, aqvis komunitare është pak më shumë. Është trup i marrëveshjeve që janë tritis, ligjeve, rregulloreve dhe normave të Unionit Evropian. Kjo është aqvis komunitare. Edhe nëse një ligj nuk është në përputhje me normat, nëse agjencioni thotë kërkund nuk e kemi gjetur, do të thotë nuk është në përputhje me normat të cilat ekzistojnë në Unionin Evropian, do të thotë nuk është në përputhje me aqvis komunitare.

Pjesa tjetër për të cilën do të flas unë, është se ky ligj përkundër qëllimit të mirë, përkundër se për çka është punuar, është punuar me kujdes, e hap një vrimë të madhe për korrupsion, shumë të madhe, për shkak se ky ligj nuk mund të quhet Ligji për

kualifikimet kombëtare, por Ligji për themelimin e Autoritetit për Kualifikime Kombëtare. Nuk e rregullon kualifikimin, e rregullon veç një autoritet. Edhe, nëse një autoritet fillimisht rregullohet për ta rregulluar një fushë kaq të madhe, unë po ju them se është shumë e mundshme që të ketë korrupsion dhe i propozoj Kuvendit që të kërkojë prej Qeverisë, që tash e tutje Agjensioni Antikorrupsion t'i marrë ligjet paraprakisht, para se të na vijë këtu dhe ata ta bëjnë një deklaratë për shkak se është Agjencion nuk është Zyre antikorrupsion. Zyra na i merr neve deklaratat e pasurisë, gjysma gënjejnë, por nuk është me rëndësi, dhe atë punë e kryejnë. Agjensioni duhet t'i studiojë format sistemime të korrupsionit, për atë është quajtur Agjencion edhe tash e tutje besoj që ai agjencion duhet ta kryejë punën e vet, duhet t'i marrë ligjet paraprakisht dhe t'iu bashkëngjij një deklaratë me të cilën thotë: A e nxitë, a po e pengon korrupsioni një ligj, për shkak se ligjet ndikojnë drejtpërdrejt në korrupsion, do me thënë një Qeveri e cila i ka vu vetës detyrë si prioritet luftën kundër korrupsionit duhet mendojë që ta fuqizojë Agjencionin Antikorrupsion.

Tjetra është, pse po flas për korrupsion të këtij ligji. Forma më e dëmshme e korrupsionit është kur bëhet në arsim. Nuk po flas për vjedhje të vogla, po flas se kur degradohet sistemi i gradimit në arsim edhe ministri Enver Hoxhaj definitivisht e dinë më mirë se shumica prej nesh këtu çka donë me thonë kur njerëzit kualifikohen e nuk dinë. E kanë një kualifikim zyrtar, por nuk dinë as të shkruajnë, nuk dinë as të lexojnë. Kjo është një dëm i madh që i bëhen shoqërisë, një dëm i madh që na bëhet neve. Degradohet sistemi i arsimit, degradohet ekonomia, po degradohen totalisht edhe ata njerëz që me të vërtetë kanë studiuar dhe kanë mbërri grada shkencore edhe duhen të krahasohen me dike që asgjë nuk di.

Në fund të fundit, edhe një herë dua ta përsëris se nuk e mbështesim këtë ligj kësisoj, implikimet buxhetore nuk janë treguar siç duhet edhe kërkojmë prej Kuvendit, duke u nisur prej këtij momenti që të kërkojë prej Qeverisë që edhe Agjensioni Antikorrupsion t'i sjellë vlerësimet e veta për cilindo ligj që vjen para nesh. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në radhë është Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Për fjalë është paraqitur, Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit!

Përshëndetje,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për kualifikimet kombëtare dhe e kemi vërejtur edhe ne se kjo fushë është e parregulluar me ligj, kështu që ne jemi që të përmirësojmë njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe njohjen e kualifikimit që e ceka më lartë, domethënë në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin formal dhe joformal ose atë informal, i cili do të sigurojë përmbushjen e nevojave të tregut të punës, ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Ne si Grup Parlamentar e përkrahim në parim këtë projektligj dhe vërejtjet dhe sugjerimet tona eventuale, do t'i japim gjatë procedurave të amendimit të mëtejshme të këtij projektligji.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës Grupi Parlamentar ” 7+”, për fjalë është paraqitur deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, Predsedniče.

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i smatra da će ovim zakonom, kada bude usvojen, da se popuni jedna prazina koja je delimično bila popunjena na Kosovu kada su u pitanju kvalifikacije. Mislim da će autoritet koji se formira i koji će biti na jednom visokom nivou, mislim po onome što dobija kompetencije, verovatno srediti jedno stanje koje je dosta nesredjeno na Kosovu, zato što u ovom trenutku ima teritorije na Kosovu, koja priznaju ili ne priznaju još diplome unutar Kosova. Ja mislim da će to biti jedna ... do sada je bilo da neki universiteti u jednom trenutku nisu priznati i tako dalje, mislim da će ovaj Zakon neke stvari dovesti u red.

Mi ćemo kao grupa dati svoj doprinos u Funkcionalnoj komisiji a i u drugim komisijama. Oцениćemo dalje ovaj Zakon u Komisiji za prava i interese zajednica, čije odredbe zaista ne zadiru u prava, ne krše prava i interese zajednica, mislimo da nije, ali to ćemo utvrditi kada budemo analizirali ovaj zakon podrobnije.

Ovaj Zakon ima budžetske implikacije, ima i prihode. Implikacije su prikazane u naredne dve-tri godine, ali prihodi nisu. Verovatno se predpostavlja da će imati određenih prihoda. Ovo što je govorio kolega Gjini, mislim da je uputno da i Agencija protiv korupcije treba da da neko svoje mišljenje o zakonima koji se nude, kada su zakoni u kojima se radi sa, da ne kažem sa izdavanjem dokumenata, i tako dalje, da li postoje praznine, da li su moguće određene praznine gde se može provući neka negativna pojava.

U svakom slučaju, naša grupa će dati svoj doprinos i u načelu podržavamo ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të SLS-së. Fjalën e ka deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala gospodine predsedniče!

Poštovane kolege poslanici,

Poštovani ministri,

U ime Parlamentarne grupe Samostalne liberalne stranke mogu da kažem da ćemo u načelu podržati da ovaj Zakon udje u skupštinsku proceduru, međutim moramo zaržiti pravo da sa svojim prvim timom razmotrimo Zakon malo podrobnije i da kroz funskonalne komisije i Komisiju za prava i interese zajednica damo svoj konačni sud, jer kao što znate, ovo jeste neophodno da se usvoji na teritoriji Kosova, ali po Ahtisarijevom planu predviđaju se određene specifičnosti iz obrazovanja na srpskom jeziku. I ukoliko ovaj Zakon ne bude imao nekih istinskih suprotnosti sa onim šta predviđa Ahtisarijev plan, mi ćemo podržati i usvajanje ovog zakona, u protivnom iznećemo svoje primedbe i nećemo podržati. Hvala vam!

KRYETARI, Ju faleminderit!

Kemi një numër të caktuar të deputetëve të paraqitur për fjalë, por konsideroj që ka ardhur koha për një pauzë dhe vazhdojmë seancën në orën 13.30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë, kuorumi nuk na duhet për debat. Ne po vazhdojmë debatin dhe kur të marrim vendim e kontrollojmë se sa e kemi numrin e deputetëve prezentë.

Kështu që unë ia kisha dhënë fjalën për debat, deputetit Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Lidhur me Projektligjin Grupi ynë Parlamentar e dha fjalën e vet, e përkrahim atë Projektligj.

Mirëpo, duke mos qenë i pranishëm në kohën e shqyrtimit të procesverbalit, me qenë se në procesverbal nuk është e shkruar, në transkript kam lexuar, e kam lëshuar një term atributiv lidhur me seancën e kaluar kur është shqyrtuar Programi qeveritar dhe si duket është ndier dikush nga komuniteti serb i ofenduar lidhur me atë çështje, kërkoj falje, mirëpo nuk ka pasur një qëllim të tillë lidhur me atë çështje. Kam dhënë premtime se do ta rregulloj këtë çështje.

Faleminderit.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Një shembull i mirë.

Vazhdojmë me debatin. Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

I nderuari Kryetar,

Unë do të diskutoj lidhur me ligjin dhe mendoj se Ligji për kualifikime kombëtare vërtet është një promotor i mësimit gjatë gjithë jetës dhe, gjithashtu, kontribuon në mobilitetin e fuqisë punëtore, natyrisht, nëse veprimet janë të harmonizuara me Kornizën e Kualifikimeve Evropiane për mësimin gjatë gjithë jetës, sipas miratimit të Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Unë, gjithashtu, e kuptoj se situata në Kosovë është ende herët që të flasim për një harmonizim të tillë, por është hap i mirë dhe është hap i drejtë. Por, duke marrë parasysh disa gabime faktike që janë në Ligjin për kualifikime kombëtare, unë do t'i rendis disa prej sugjerimeve të mia për Komisionin për Buxhet dhe Financa, por edhe për Komision për Arsim.

Në nenin 9 të kapitullit 3, pika 1, ku thuhet se Këshillin drejtues prej 13-vetave, të miratuar nga Qeveria e Kosovës, ata do të përfaqësojnë ministrinë, organizatat e partnerëve social dhe universitetet publike.

Këtu do t'i kisha ngritur 2 momente. Momenti i parë është, sepse në deklaratën financiare të ligjit në fjalë thuhet se Këshilli Drejtues sipas vlerësimit të ndikimit financiar, anëtarët e këtij këshilli do të paguajnë nga 200 euro në muaj për 8 mbledhje gjatë vitit, gjë që drejtpërdrejt bie në kundërshtim me Ligjin e financave publike, bie në kundërshtim me nenin 78 të Ligjit të financave publike ku nuk kanë të drejtë për kompensim shtesë. Citoj, Ligjin për financa publike: “Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik, ose organizate buxhetore sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë dhe nuk mund të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim”. Kjo mua më bën që ne të gjithë të mendojmë që ta ngrehim një çështje se mos

t'i vëmë në pozita të palakueshme zyrtarët në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sepse ata nëse lejojnë një gjë të tillë, mund të bëhen subjekt i një procedure gjyqësore.

Gjithashtu, për shkak se ne me Kushtetutën e Kosovës jemi orientuar për një ekonomi të tregut, për një ekonomi të hapur, momenti i dytë në këtë nen do të ishte që të mendohet për përbërjen e këtij këshillit drejtues dhe që t'u japim mundësi të barabarta të gjitha universiteteve, qofshin ato publike apo edhe private.

Kjo çështje që unë tash ngrita mendoj që do të duhej të kihet parasysh nga Komisioni për Buxhet dhe Financa edhe për ligje të tjera, sepse ne të gjithë e dimë që ka shumë zyrtarë, ka shumë shërbyes civil që paguhën nga paraja publike, që marrin pjesë nëpër borde të ndryshme dhe marrin edhe pagesa shtesë, kur një gjë e tillë është e ndaluar.

KRYETARI: Sigurisht ka qenë e ndaluar edhe më herët.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit që e ngrite, por deri më tash me Ligj të financave publike, jo. Ky është nen i ri i futur në Ligjin për financa publike.

Gjithashtu, unë do të ngreh edhe një çështje në nenin 12 nën pikën 2. Neni 12.2 : "Personelin e përhershëm me orar të plotë në pajtim me Rregulloren për shërbyesit civil e zgjedh drejtori në konsultim me Këshillin Drejtues të AKK-së."

Të nderuar deputetë,

Me momentin që ne i kategorizojmë shërbyes civilë, atëherë futen në veprim procedurat për regrutim. Nuk mund të flasim për procedura për regrutim dhe të njëjtën kohë të flasim për zgjedhjen nga ana e drejtorit dhe nga bordi drejtues. Kjo, gjithashtu, bie në kundërshtim me Rregulloren për shërbimin civil 2001/36 dhe për procedurat e miratuara në vitin 2003 nga Ministria e Shërbimeve Publike.

Dhe, së fundi, në kapitullin e 6-të, në nenin 20, thuhet: Në raste të rënda ku konstatohet një papajtueshmëri e vazhdueshme me kriteret, AKK mund të tërheqë akreditimin. Unë mendoj që ky nen do të duhej rishikuar edhe një herë që të jetë në funksion të zgjedhjeve të problemeve dhe që të ketë një saktësi dhe qartësi të ligjit, kështu që sugjerim imi është që të jetë më i saktë nga pikëpamja teknike se për çka bëhet fjalë. Çka do të thotë e rëndë, çka do të thotë e lehtë, cilat janë shkeljet që bëhen, sa është vazhdimësia a është 3, 100, 50 herë e tutje?

Në parim mbështes Ligjin, por mendoj që dy komisionet, edhe Komisioni për Buxhet, edhe Komisioni për Arsimit do të duhej rishqyrtuar dhe amenduar Ligjin në fjalë.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, i nderuari zoti Kryetar!

I nderuar ministër Gashi dhe ministërja Kelmendi,

Më lejoni të shpreh së pari keqardhjen që nuk është ministri i Arsimit këtu që të mund t'i marrë sugjerimet që i kemi për te.

Megjithatë, sa i përket Projektligjit për kualifikimet kombëtare, është evidente se Kosova ka nevojë për zhvillimin e edukimit të bazuar në kompetencë dhe se duhet të bëhet një kornizë ligjore që rregullon sistemin kombëtar të kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit, por që, gjithashtu, përmbushin nevojat e tregut të punës.

Prandaj, ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe duhet t'i plotësojë të gjitha komponentët që duhet t'i përmbajë një ligj në mënyrë që të zbatohet në praktikë. Por, e ka një mangësi të rëndësishme që e vë në pikëpyetje zbatimin e tij e që është ndikimi i tij në buxhetin e Kosovës. Sipas këtij projektligji, është paraparë që për 2 vjet - 2009-2010 , kostoja buxhetore e Projektligjit të jetë 149 490 euro, por zgjidhja e mënyrës së financimit është e ndryshme nga përgjegjësitë të cilat dalin nga projektligji dhe ato që parashohin financimin e autoritetit kombëtar të kualifikimeve. Me qenë se ky autoritet parashihet të jetë një agjencion i themeluar nga MASHT-i, i cili duhet të rregullojë sistemin kombëtar të kualifikimeve, duke filluar nga politika, pastaj strategjitë, por edhe mbikëqyrjet, parashihet që të financohet edhe nga ministritë e tjera dhe nga donatorët, kurse të gjitha përgjegjësitë tjera të parapara në projektligj, parashihen të financohen nga buxheti i Kosovës.

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit ka paraparë edhe të hyrat vetanake që duhet të dalin nga taksat dhe pagesat prej institucioneve të arsimit dhe aftësimin, por nuk dihet vlera e saktë e këtyre ose shuma e saktë e të hyrave. Prandaj, kemi ndikim negativ në Buxhetin e Kosovës, sepse shuma e shpenzimeve është më e madhe se sa e të hyrave.

Prandaj, si deputete e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës propozoj që të bëhen 2 korrigjime të rëndësishme, në mënyrë që ligji të zbatohet. E para, është vlerësimi i saktë i këtyre të hyrave dhe kjo duhet të rregullohet me akt nënligjor dhe, e dyta, gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2009, duhet të parashihen shpenzimet si dhe 6 punëtorë që janë paraparë me këtë projektligj që janë drejtori dhe 5 zyrtarë. Për shkak të kësaj mangësie të rëndësishme, unë nuk mund ta përkrah këtë projektligj dhe shpreh edhe njëherë keqardhjen që nuk është ministri këtu për të marrë parasysh këtë dhe për ta ndryshuar projektligjin dhe atëherë me ato ndryshime ta sjellë në Kuvend Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra.

Fusha e edukimit dhe arsimit është e gjerë dhe komplekse, prandaj vlerësimi i ekspertëve që rregullimi me ligj të veçantë të sistemit kombëtar të kualifikimeve e ndihmon përforcimin kualitativ të edukimit dhe arsimit në të gjitha nivelet që sigurohen përmes kualifikimeve të ofrojë qasje në arsim dhe aftësim përmes trajnimeve, gjë që mundëson progres dhe transformim për të gjithë, përmbush nevojat e tregut të punës, bën vlerësimin dhe certifikimin në bazë të cilësisë dhe të standardeve, vlerëson mësimin paraprak dhe njëkohësisht dispozitat e këtij projektligji rregullojnë zhvillimin, mbrojtjen e kornizës kombëtare, dhënien e kualifikimeve dhe certifikimin në të gjitha nivelet e arsimit formal dhe joformal, rregullon mënyrën e organizimit, kriteret dhe

procedurat për kualifikimet si dhe përcakton obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat e institucioneve që trajtojnë këtë lëmë.

Duke i dituar rrethanat për gati 2 dekada të zhvillimit të procesit të arsimit dhe të edukimit jo në nivelin e duhur, e në veçanti do të potencojë përfshirjen e femrës, dispozitat e Projektligjit nxisin zhvillimin e mësimi gjatë gjithë jetës .duke përfshirë zhvillimin e shkathhtësive për të rritur të mbështetur me sigurimin rigoroz të cilësisë, prapë po e potencoj, krijon mundësitë që edhe femra edhe më tutje të arsimohet dhe të aftësohet për të realizuar vend të punës.

Në kapitullin 5 akreditimi dhe përgjegjësitë e institucioneve të vlerësimit përgjegjësitë janë përcaktuar në mënyrë të përgjithësuar. Kërkesa që duhet përmbushur këto institucione rregullohen me akte nënligjor. Do të ishte mirë që këto përgjegjësi të definohen me dispozita në këtë projektligj. Ajo që vlen për t'u potencuar është se kohë pas kohe institucionet e vlerësimit bëjnë rishikimet periodike të vlerësimit dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve, një standard dhe transparencë të vazhdueshme.

Në memorandumin shpjegues të Projektligjit për kualifikimet kombëtare, pika 10, thuhet se hartimi i projektligjit është në harmoni me ligjet e Bashkimit Evropian, kurse në deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së krijon një konfuzion, duke dhënë sqarime se projektligji nuk është drejtpërdrejt në harmoni me *acquis communautaire* të BE-së, se Projektligji përcakton obligime për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve dhe krijon mundësi që të hartojë akte nënligjore në fushën përkatëse.

Edhe për kundër kësaj projektligji lënë shpresë se në një të ardhme të afërt krijon mundësi të njohjes së kualifikimeve dhe të diplomave të qytetarëve tanë, shfrytëzimin e beneficioneve, bërjen e praktikave me interes profesional, krijon lirinë e punës për një kohë të caktuar për ushtrim të profesionit pa aplikuar njohjen e diplomave dhe të kualifikimeve në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Projektligjin e përkrah në parim se rregullon për herë të parë një segment mjaft me interes për qytetarët tanë. Ka implikime buxhetore, por në të njëjtën kohë ka edhe të hyra vetanake. Projektligjin e përshkon një financim, por në anën tjetër, me asnjë dispozitë nuk caktohen dispozita të cilat ndëshkojnë mekanizmat apo institucionet të cilat bëjnë kualifikimet kombëtare.

Prandaj, do të ishte mirë që me ndonjë dispozitë të caktohen sanksionet për ata të cilët nuk i kryejnë punët me kohë dhe afat të caktuar.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar,
Të nderuar ministra, deputetë,

Fillimisht do të isha angazhuar që të meditohej për emërtimin e ligjit. Vlerësoj se nuk është formuluar logjikshëm kur thuhet: Ligji për kualifikimet kombëtare. Kjo e zgjon një asociacion dimensionit tjetër, eventualisht për kualifikimet shtetërore. Unë do të kisha propozuar si një ndër variantet e mundshme, nuk po e quaj projektligj se ky do të bëhet ligj, “Ligji për klasifikimin, fitimin dhe njohjen e kualifikimeve arsimore” edhe këtu hynë prej abinicio, prej fillores deri në doktoratë, e kështu me radhë.

Ju lutem, ekziston një pasazh këtu që do të lexoj, është krejtësisht konfuz edhe gjithsesi jep një ton krejt tjetërfare përmbajtjes së këtij- topikut. Thuhet:” Qëllimi i Projektligjit është krijimi i sistemit kombëtar të kualifikimeve që bazohet në kornizën kombëtare të kualifikimeve të rregulluara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.” Ju lutem, këtu del se ky ligj e ka bazë apo do të duhej ta kishte bazë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. Ligji është akt juridik i përgjithshëm- numër 2 pas Kushtetutës dhe gjithmonë e kurdoherë duhet ta ketë bazament edhe fundament e pikënisje dispozitën përkatëse të Kushtetutës. Aq më pak, kur Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në procedurë të caktuar duhet ta miratonte Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, e Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve do ta themelonte MASHT-i -Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji që del, domethënë, një konfuzion dhe një kontradikcion krejtësisht. Prandaj, kjo do të duhej me të vërtetë të rishikohej edhe të riformulohej.

Ka mjaft formulime të këtilla, unë do ta marrë vetëm një aline. Thotë: ” Të përmirësojë objektivi i Projektligjit paraqiten, të përmirësojë njohjen e kualifikimeve e tjera”. Do të thotë, është e vërtetë se nuk është njohja e kualifikimeve në rregull, mirëpo këtu thotë ta përmirësojë, do të thotë prapëseprapë zgjon asociacion se nuk e ka pretendimin për ta rregulluar këtë, por për ta përmirësuar, apo jo. E unë do ta kisha propozuar këtë që të thuhet, po e zëmë në vend që ta përmirësojë, ta sigurojë njohjen, të shtohet “adekuate”, domethënë “ta sigurojë njohjen adekuate të kualifikimeve”. Ky do të ishte objektiv serioz.

Edhe ju lutem, sa i përket inpaktit financiar, thanë kolegët e nderuar Rrustemi edhe Sylja, plotësisht me vend, e unë do të kisha shtuar edhe këtë. Para 100 vjetëve ka ekzistuar një person që e ka pas emrin Parkins. Ai paska qenë kolonel edhe kur ka dalë në pension e paska pas themeluar një partnership. Një herë e paska pas mbajtur administratën vetë, por mandej e ka bindur një ndihmës që duhet edhe një edhe ka shkuar numri 21. E ka shitur krejt pasurinë dhe është marrë me studime edhe ai ligj quhet ligj si fenomen kështu në administratë. Administrata është imanente me fryrjen e numrit të nëpunësve.

Ju lutem, sot cilado ministri e sotme ka më shumë nëpunës e punëtorë se sa krejt Qeveria që ka qenë para një periudhe të caktuar, aq më parë kur sot, po e zëmë, ka mjete teknike të punës moderne që do të supozojmë me vend se një person me një kompjuter do të duhej t’i zëvendësonte 100, tash po del e kundërta.

Bie fjala, sot është modë e madhe, këshillat drejtuese kanë ekzistuar gjithmonë. Në këshillin drejtues ka qenë prestigj për të qenë anëtar, porse nuk ka pasur benificione financiare. Sot unë kam lexuar, nder të tjera, në shtypin ditor se një person i paska marrë 20 e disa mijë euro në muaj nëpër borde dhe ky është sekret publik se nuk dihet sa e merr anëtari i bordit kompensimin krejtësisht të paligjshëm, ju lutem. Ta marrim atë pagesë marramendëse inmeritore me pagesën e një invalidi të luftës a të një të papunësuarit etj. Edhe këtu tash propozohet që ky bord të kishte 13 veta, po e zëmë, e tjera. Do të duhej të rishikohej kjo. Do të duhej që në kuadrin e Ministrisë të jetë një shërbim edhe po e zëmë zëvendësministri për çështje të caktuara ta kryesonte këtë punë dhe Ministria ta bënte këtë punë që mund ta bëjë edhe do ta bënte në mënyrë të kualifikuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, debati është shteruar. Fjalën e ka kërkuar ministri Hoxhaj.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, shumë zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryetar,
Zonja ministre,
Të nderuar deputetë,

Vërtet s'e kam ndërmend që t'ju marr shumë kohë, e kam ndërmend vetëm të marr qëndrim ndaj disa dilemave që u ngritën.

E para, ky ligj bazohet në atë se çfarë thirret Korniza Kombëtare e Kualifikimeve. Ata që e njohin procesin e integrimi evropian, që e njohin aquis communautaire e që e njohin politikën arsimore e dinë që aquis communautaire dhe politikën arsimore nuk kanë asgjë të përbashkët. Mund të integrohesh në Bashkim Evropian, se nuk është parakusht. Mirëpo, Bashkimi Evropian ka mekanizma të tjerë të cilët thjesht vendet e caktuara i shtojnë drejt reformave në përputhje me objektivat dhe standardet e Bashkimit Evropian dhe ato janë strategjia e Lisbonës, Konventa e Kopenhagës për Arsim Profesional dhe Deklarata e Bolonjës për Arsim të Lartë, përderisa strategjia e Lisbonës i referohet tërësisht sistemit arsimor, kështu që të hapet debati rreth aquis communautaire dhe sistemit arsimor është më tepër një debat i cili nuk i takon edhe këtij Kuvendi se ma merr mendja se çdo kush që i njeh këto dy gjëra s'ka nevojë që pa tjetër t'i ngatërrojë.

Çështja e dytë, që dua të ngrit është që ligji parasheh që të hapet rruga për hartimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Fjala kombëtare këtu është e përkthyer nga gjuha angleze që është nacional, që është e barabartë me shtetërore. Mirëpo, meqë në të gjitha vendet që janë shtete dhe vende që sa kohë përdoret fjala Kornizë Kombëtare Kualifikimeve edhe në gjuhë angleze, edhe në gjuhë franceze, edhe në gjuhë gjermane, edhe në gjuhë të tjera, ne e kemi përdorur terminologjinë e njëjtë, meqë ky instrument të jetë i përthyeshëm me Kornizën e Kualifikimeve Evropiane.

Çështja e tretë, sepse u ngritën shumë dilema edhe unë nuk e kam ndërmend vërtet të polemizoj me askënd, ju falënderoj shumë për debatin. Por, më lejoni t'ju shpjegoj se çka i bie në thelb, se u bë pakëz si shkencë bërthamore ky debat rreth Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.

Ndër të tjera, e rregullon edhe një situatë të cilën shumë të rinj nga Kosova e kanë përjetuar, ma merr mendja që ka edhe të tillë që e njohin shumë mirë edhe në Kuvendin e Kosovës. Në Britani të Madhe kanë shkuar njerëz nga Kosova që kanë pasur mundësinë pa diplomë të universitetit për të shkuar direkt në magjistraturë. Ata që nuk e dinë, ka qenë Korniza Kombëtare e Britanisë së Madhe që u ka lejuar që t'u njihet dija paraprake dhe kanë shkuar në një gradë të magjistraturës. Ajo magjistraturë dhe këtu prapë dal te tema të tjera, nënkupton që ke magjistraturë profesionale që janë master of arts, ke magjistratura shkencore, ke doktoratura profesionale, ke doktoratura shkencore, prandaj ky ligj i formës si është, ofron fleksibilitet për sistemin tonë arsimor. Unë mendoj që në formën si është ofruar dhe merita është mbi të gjitha e atyre që kanë punuar këtë ligj më herët, vërtet duhet të miratohet, ndërsa çdo koment tjetër që ishte kështu i natyrës moralizuese që duhet të merret Agjencia për Antikorrupsion mbi këtë ligj, unë i kisha sugjeruar që ta zgjeroni veprimtarinë e Agjencisë për Antikorrupsion sa i përket këtij ligji edhe ngrohjen globale, meqë po hyjmë kohë të nxehta, ta definoni si punë të Agjencisë për Antikorrupsion, se besoni që është ngatërrim aq shumë i gjërave sa që e tejkalon përmasën e çdo debati profesional.

Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

A keni replikë? Emrin s' ta ka përmendur, megjithatë, urdhëro. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Po, emrin me të vërtetë nuk e përmendi ministri, po ishte në kontekst të asaj që kam thënë unë. Në Kuvend e kemi përmendur disa herë, ne nuk jemi këshill profesional këtu, jemi deputetë edhe debati ynë nuk është debat profesional, por është debat politik, debatet profesionale bëhen tjetërkund. Para se të vijë ligji këtu, ka qenë dashur që të bëhen ato debate. Ky është një prej përmirësimeve.

Dhe, e fundit është që unë nuk thashë që Agjencioni Antikorrupsion duhet të merret me këtë ligj, sugjerimi im ishte që Agjencioni Antikorrupsion si Agjencion që është, të merret me krejt ligjet edhe ta bie një deklaratë të veten edhe të tregojë se në formën sistimore a ndikon ligji në korrupsion apo jo? Këtë e thashë me qëllim për të treguar se është agjencion e jo zyre antikorrupsion, e cila vetëm na i mbledh neve deklaratat e pasurisë. Agjencioni sugjeron, jep ide, prodhon ide edhe në fund të fundit jep sugjerimet e veta se një ligj në formën sistimore a krijon kushte për korrupsion apo jo? Kjo është ajo çka thashë unë.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit: Ju lutem, nuk është paraqitur më askush për fjalë, andaj kalojmë në votim. Në sallë janë prezentë 66 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

A ka ndonjë deputet që nuk ka kartelë? Mirë, faleminderit!

Konstatohet se me 50 vota "për", 7 vota "kundër" dhe 2 abstenime, miratohet ligji.

Në bazë të Rregullës 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione.

1. Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini e Sport, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete dhe
5. Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhen që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: SLOBODAN PETROVIĆ

Idemo na petu tačku:

- Drugo razmatranje Nacrta zakona o vanparničnom postupku

Usvajanja Nacrta zakona u načelu obavljeno je 27. februara 2008. godine.

Parlamentarne komisije su razmatrale Nacrt zakona u Skupštini, podnele su izveštaj sa preporukama.

Komisija za prava i interese zajednica ocenila je da odredbe Nacrta zakona i predloženi amandmani ne ugrađavaju prava i interese zajednica.

Komisija za buždet i financije je ocenila da odredbe Nacrta zakona i predloženi amandmani ne sadrže budžetske implikacije.

Komisija za zakonodavstvo, kao glavna, funkcionalna i izveštajna komisija, ocenila je da odredbe Nacrta zakona imaju pravnu osnovu u Ustavnom okviru i preporučuje Skupštini, usvajanje istog sa predloženim amandmanima.

Pre nego što počnemo sa glasanjem o predloženim amandmanima, pozivam predsednika ili izvestioca funkcionalne komisije ako vidi za potrebnim da obrazloži izveštaj sa preporukama. Ovo pravo imaju i predstavnici glavnih komisija.

Izvolite, poslanik Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Përshëndetje e nderuara ministre,

Mendoj që raportin e kemi hartuar dhe vetëm nëse ka nevojë për ndonjë sqarim do të jemi të gatshëm ta bëjmë si Komision.

Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Prelazimo na glasanje i usvajanje predloženih amandmana od strane funkcionalne komisije po prijavljen redosledu za izveštaj.

Amandman 1.

U celom tekstu Nacrta zakona, reč „gjyqtar“ zamenjuje se rečju „gjykatës“.

Režija spremna za glasanje: Glasamo sad:

57 poslanika je glasalo, 56 „za“, i 1 „protiv“, nema uzdržanih. Hvala!

Amandman 2.

Režija, Glasamo sada:

Glasalo je 57 poslanika, 56 „za“, 1 „protiv“.

Amandman 3.

Režija, glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 56 poslanika, 55 „za“, 1 „protiv“.

Amandman 4.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 54 poslanika, 54. „za“.

Ukupno u sali je prisutno 63 poslanika.

Ima li neko da nema karticu? Hvala, idemo dalje.

Amandman 5.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 57 poslanika, 56 „za“, 1 „protiv“.

Amandman 6.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 56 poslanika. 54 „za“, 2 „protiv“.

Amandman 7.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sada:

Hvala! 55 je „za“, 1 „protiv“.

Amandman 8.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sad:

Hvala! 55 je „za“, 1 „protiv“ i 1 uzdržan.

Amandman 9.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 55 poslanika, 53 „za“, 1 „protiv“ i 1 uzdržan.

Amandman 10.

Molim režiju da se pripremi za glasanje i glasamo sada:

56 poslanika je glasalo, 54 „za“, 1 „protiv“ i 1 uzdržan.

Amandman 11.

Glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 54 poslanika, 53 je „za“ i 1 uzdržan.

Amandman 12.

Želim da vas informišem da u sali ima 64. poslanika, ali neko ne glasa, očigledno.

Izvolite, poslanik Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsedavajući,

Ja sam uporno hteo po tom pitanju da otvaram diskusiju. Znači, nisam toliko siguran pošto sam nov poslanik u ovom sazivu, ali u Pravilu 31. kvorum i glasanje, pod stvom 3, stoji da odluke koje donosi Skupština, smatraju se punovažnim, ako je prilikom njihovog donošenja prisustvovalo više od polovine ukupnog broja poslanika.

Nakon izvršenog elektronskog glasanja, nikada se nije pojavio broj od 59. 57 glasova „za“ 1 „protiv“, 1 uzdržan. Ili ostali poslanici moraju da se izjasne na neki način, ili stvarno moramo da utvrdimo kvorum, zato što imamo situaciju da se pojavljuje 54 poslanika da su prisutni. Prisutni, ali mi po glasanju imamo situaciju da je prisutno ispod 60 poslanika stalno.

KRYESUESI: Hvala vam na tumačenju, ali 64 poslanika ima u sali i to je dovoljno za kvorum. To je više od polovine. Sada imamo 65 poslanika.

Dobro, idemo dalje, u sali imamo 65 poslanika.

Idemo na glasanje amandmana 12.

Molimo režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada.

Hvala! Glasalo je 62 poslanika, 57 „za“, 1 „protiv“ i 4 uzdržanih.

Amandaman 13.

Dobro, Hvala! Tehnička služba kaže neka koristi moju karticu.

Dobro idemo dalje, idemo na Amandman 13.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada.

Hvala! Glasalo je 56 poslanika, 53 „za“, 1 protiv i 2 uzdržana.

Amandman 14.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada.

56 poslanika je glasalo, 54 „za“, 2 su uzdržana.

Amandman 15.

Molim režiju da se pripremi za glasanje

Glasamo sada.

56 poslanika je glasalo, 54 „za“, 2 uzdržana.

Amandman 16.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada.

59 poslanika je glasalo, svih 59 „za“ Hvala!

Dakle, molim poslanike i režiju da se pripreme za glasanje za tekst Nacrta zakona u celosti sa usvojenim amandmanima.

Ja se izvinjavam, imamo i Amandman 17.

Idemo još jednom da glasamo Amandman br. 17.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada.

Glasalo je 60 poslanika, 59 „za“, 1 uzdržan. Hvala!

Sada molim poslanike i režiju da se pripreme za glasanje za tekst Nacrta zakona u celosti sa usvojenim amandmanima.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Hvala! Glasalo je 63 poslanika. 60 „za“ i 3 su uzdržana.

Hvala!

Skupština je usvojila Nacrt zakona o vanparničnom postupku.

Idemo na šestu tačku dnevnog reda:

- Drugo razmatranje Nacrta zakona o izvršnom postupku

Usvajanje u načelu ovog Nacrta zakona obavljeno je 27. februara 2008. godine. Parlamentarne komisije su razmatrale Nacrt zakona i Skupštini podnele izveštaj sa preporukama koje slede.

Komisija za prava i interese zajednica je ocenila da odredbe Nacrta zakona i predloženi amandmani ne ugrožavaju prava i interese zajednica.

Komisija za budžet i finansije je ocenila da odredbe Nacrta i zakona, pruženi amandmani ne sadrže budžetske implikacije. I Komisija za zakonodavstvo, kao glavna, funkcionalna i izveštajna komisija, ocenila je da odredbe Nacrta zakona imaju pravnu osnovu na Ustavnom okviru i preporučila je Skupštini usvajanje istog sa predloženim amandmanima.

Pre nego što počnemo sa glasanjem predloženih amandmana, pozivam predsednika ili izvestioca funkcionalne komisije, ako vidi potrebnim da obrazloži izveštaj sa preporukama. Ovo pravo imaju i predstavnici glavnih komisija.

Reč ima poslanik Bahri Hyseni. Izvolite!

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit!

Mendoj se e kemi dorëzuar me shkrim dhe vetëm nëse ka nevojë për ndonjë qartësim eventual.

KRYESUESI: Hvala! Nema niko više? Kolega Gani Koci, izvolite!

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Vetëm një sqarim rreth rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me këtë projektligj, nëse është fjala për Projektligjin për procedurën përmbartuese. Komisioni i ka shqyrtuar rekomandimet ose amendamentet e 25 prillit 2008, të Komisionit funksional dhe ne kemi hasur si Komision një paqartësi në amendamentin 7 që i referohet nenit 12.5, dhe e shoh këtu, kemi kërkuar një sqarim një sqarim rreth kësaj. Po e shoh një raport tjetër që është i 22 prillit 2008, që ky amendamenti 7 nuk i referohet, nuk është i njëjtë me amendamentin 7 të këtij raporti, të datës 25 prillit. Tash nuk di cila është valide këtu, a është ky i 22 prillit apo ky i 25 prillit, që është më i vonshëm se kjo? Ne të dy materialet i kemi këtu, prandaj, do të duhej një sqarim rreth kësaj. Nëse është fjala për raportin e datës 25 prill 2008, amendamenti 7 thotë kështu: për nenin 25.2, në reshtin e tretë, fjalia “në trup gjykues përbërë prej 3 gjyqtarëve profesional...” nuk thuhet as të fshihet as t’i shtohet dikujt as të hiqet apo diçka, prandaj do të duhej këtu ta dimë se me cilin dokument po punojmë ne dhe të cilave amendamente duhet t’i referohemi ne këtu?

KRYESUESI: Hvala. Molio bih predsednika glavne komisije, Bahri Hyseni, da li ima komentar?

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit!

Unë mendoj që propozimet që i keni marr, propozimet përfundimtare janë ato të cilat janë rekomanduar dhe këtu duhet të ndalemi. Nuk po e di për çfarë raporti po flitet, por ju e keni para vetes propozimin përfundimtar të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të kërkojmë sqarimet, cili nen? Nëse është neni 7, unë mendoj që nuk lidhet me grupin gjyqësor. Mirë, ta ngrinim vetëm çështjen ku?

KRYESUESI: Molim režiju da uključi mikrfon za kolegu Kocija. Gani Koci, izvolite!

GANI KOCI: Ju lutem, unë i kam dy dokumente që kanë ardhur prej Komisionit për ligje, që ka qenë komision funksional. Dokumenti i parë që e ka vulën dhe datën e protokollimit dhe i dyti që e ka një datë dhe vulë, po ashtu, të protokollimit. Njëri është i datës 25 prill të vitit 2008, tjetri është i 22 prillit të 2008, prandaj cili është dokumenti i fundit i këtij? Dallojnë në çështjen në nenin 7, amendamentin 7 njëri me tjetrin, nuk përputhen. Cili është i përputhshëm? Ne kemi punuar si komision me dokumentin që ka ardhur me datën e mëvonshme. Ky është problemi, merrni shqyrtoni, analizoni. A është çështje e Komisionit a është çështje e mbështetjes administrative të Komisionit, unë nuk di. Ne kemi punuar veç me një dokument, ndërsa tash e kemi edhe një dokument tjetër që Komisioni nuk e ka pasur në dorë.

KRYESUESI: Ja se izvinjavam, samo molim da predsednik glavne komisije daje odgovor.

BAHRI HYSENI: Ju lutemi ta lexojmë rekomandimin përfundimtar të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, është amendamenti 8, neni 12.5, fshihet fjala: “në trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarëve profesional” Amendamenti është shumë i qartë, dhe nëse ka nevojë të jepen sqarime pse ka ndodhur kjo, kem shkuar në parimin që në procedurën civile, shumica e rasteve dhe shumica e vendimeve mirren me gjyqëtarin individual dhe nuk kemi dashur që ta komplikojmë çështjen. Ky është mendim i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

KRYESUESI: Profesore, ja se izvinjavam, gospodin Makolli je tražio reč, i posle čete Vi. Izvolite kolega!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet ne po flasim për dy materiale, para vetes kemi 2 materiale. Kështu kishim edhe në Projektligjin paraprak- dy materiale që njëri i kishte 16 amendamente dhe tjetri kishte 17 amendamente. Po, kështu, tashmë kemi para vetes dy dokumente që askund nuk përputhen amendamentet e njërit me amendamentet e tjetrit. Prandaj, do të ishte mirë që të sqarohemi se për cilin dokument po flasim tash?

KRYESUESI: Izvolite, Profesor Hamiti! Molim režiju da...

SABRI HAMITI: Zoti kryesues,

Zoti sekretar i Kuvendit që je këtu,

Edhe ju deputetë dhe shef i Komisionit,

Ju që punoni me shkrim, unë po çuditem pse nuk këqyreni gjënë themelore, kur është evidentuar ky dokument dhe do t’ua jap çudirat. Dokumenti që është më i vjetër, më i vonë, që e ka datën 25 prill 2008, është evidentuar më 6 maj, ndërsa tjetri, që është më i hershëm, më 22 prill, është evidentuar më 13 maj. Domethënë, kjo është elementare që dihet që janë evidentuar dyfish. Tash, këto amendamente nuk janë të barasvlershme me numra, shtatëshi-shtatëshit s’ i përgjigjet, ju mund t’i shihni, për shembull, prandaj duhet të merret qëndrimi, cili është raport final, ta quajmë ne, edhe juridikisht i përgatitur nga ekipet teknike të Kuvendit, le ta thonë fjalën e vet ose Komisioni, përndryshe duhet të vendosim cilin po e votojmë dhe mos të humbim kohë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala kolega! Reč ima gospodin Hyseni, predsednik glavne komisije.

BAHRI HYSENI: Natyrisht që është një përzierje e punës që po ndodh në administratë, ju e kuptoni shumë drejt dhe e kemi ngritë këtë çështje jo një herë, por shumë herë, që grupet apo komisionet që mbështeten nga administrata edhe nuk kanë numër të konsiderueshëm, por edhe kanë probleme të shumta. Në të shumtën e rasteve ne jemi duke përpiluar edhe vet, jemi duke u marrë me këtë, sepse aktualisht Komisioni për Legjislacion i ka vetëm dy veta, një asistente dhe një zyrtar që e mbështet. Mirëpo, versioni i fundit është ai i datës 25 dhe versioni përfundimtar me rekomandimet që i kemi bërë, do me thënë neni 8, ashtu siç është në rekomandimin përfundimtar është ajo që duhet të qëndrojë dhe është miratimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Kjo ka qenë një përzierje e datave që i ka dorëzuar administrata, që është plotësisht me vend, sepse duhet të kenë kujdes, por nuk kemi mundësi tash pas procedimit si t' i përcjellim deri në fund çështjet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Reč ima kolega Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Jo për të polemizuar me dikë, por nuk e besoj se i gjithë faji do të duhet t'i bjerë administratës, sepse kemi të bëjmë edhe me çështje përmbajtjesore brenda këtyre dy dokumenteve. Nuk është hera e parë që ky Kuvend ka probleme të tilla. Prandaj, konsideroj se seriozisht edhe Kryesia e Kuvendit edhe grupet parlamentare edhe komisionet edhe ky Kuvend si tërësi, do të duhej të debatohet seriozisht për funksionimin e brendshëm të Kuvendit dhe trupave të saj, sepse po shihet që në vazhdimësi kemi probleme të natyrës të tillë dhe është koha e fundit që do të duhej të ndërpriteshin këto. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala kolega! Kolega Gani Koci, izvolite!

GANI KOCI: Sërish do të shfrytëzoj pozicionin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, meqë qenka ngatërrim i këtyre materialeve dhe qenka i fundit ky që e ka datën më të hershme, atëherë ne si Komision për Buxhet, rekomandimet tona i tërheqim dhe do ta shqyrtojmë në mbledhjen tjetër të Komisionit. Raportin, për të cilin konsiderojmë se është valid i Komisionit. Nuk konsiderojmë si Komision që i kemi shqyrtuar amendamentet e këtij komisioni përderisa paska pasur dy dokumente.

Ne e kemi shqyrtuar vetëm të parin që thuhet se thuhet se është valid, prandaj, për këto që sot shqyrtohen këtu, Komisioni nuk i ka shqyrtuar, ju lutem. Variantin e dytë për të cilin Komisioni konstaton se është valid, Komisioni i Buxhetit nuk e ka shqyrtuar, prandaj kërkohet që të na jepet kohë që ta shqyrtojmë këtë variant, përndryshe ne i tërheqim rekomandimet që i kemi dhënë për këtë projektligj. Jo unë po them, dua për t' i shqyrtuar dhe i jap rekomandimet dhe u krye puna.

KRYESUESI: Hvala! Reč ima ministar Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Unë mendoj se këto çështje teknike fare nuk ndikojnë në implikimet buxhetore dhe nuk ka arsye që për këtë të tërhiqet ky material, ky raport.

Nga ana tjetër, është rregull se çdo rekomandim i mëvonshëm i shfuqizon rekomandimin e mëhershëm, andaj nëse i keni marrë rekomandimet e datës 13 maj 2008, duhet të procedohet sipas këtyre rekomandimeve dhe amendamenteve që u janë bashkëngjitur këtyre rekomandimeve.

KRYESUESI: Izvolite Bahri Hyseni, predsednik Komisije.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues. Ta bëjmë edhe një sqarim edhe pse po ndalemi pa nevojë, sepse Komisioni për Buxhet dhe Financa edhe në rekomandimin e parë nuk ka bërë asnjë propozim. Prandaj, çështja është vetëm te renditja, unë mendoj se është një çështje teknike. Në propozimin e parë ka qenë nën nenin 7, që të hiqet prej 3 gjyqtarëve, tash ka kaluar në renditjen në nenin 8, për shkak se është shtuar një amendament, që është zëvendësuar fjala “gjykatës”, nuk ka në përmbajtje asgjë, nuk ka implikime buxhetore, edhe rreth propozimit të parë Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka rekomanduar asgjë, sepse nuk ka implikime buxhetore dhe nuk ka diçka që e pengon procesin. Nëse është çështja tash ta kthejmë ligjin për një çështje teknike, të cilën po e sqarojmë, po të ishte rekomandim i Komisionit për Buxhet edhe rreth dokumentit të parë, do të ishte shumë e arsyeshme, por këtu nuk ka rekomandim. Kjo është vërejtur tash në seancë që dy dokumente janë proceduar për shkak të lëvizjes së një amendamenti, ka qenë 7 dhe ka dalë 8-të, në përmbajtje është i njëjti, nuk ndryshon asgjë as në implikimet buxhetore, por as në përmbajtjen e ligjit të cilin po e shqyrtojmë në seancën e dytë plenare.

KRYESUESI: Hvala! Za reč se javio Gani Bučinca.

GANI BUČINCA: I nderuari zoti, kryesues!

E dëgjova diskutimin, do të ishte mirë megjithatë ta hedhim në vota a jemi për rekomandimin e Komisionit për Legjislacion ose ta shtyjme për seancën tjetër? Pra, me vota rregullohet kjo punë edhe të shkojmë përpara, mos të hapim debat më tutje.

KRYESUESI: Ja se izvinjavam, gospodin Ramë Buja, šef Poslaničke grupe PDK.

RAMË BUJA: Ju lus që për t'ju ndihmuar gjersa më ndieni se unë vet nuk di se për cilin të votoj. Unë kërkoj se, gjithsesi, të hiqet nga rendi i ditës kjo dhe të sqarohemi për seancën tjetër dhe pastaj të votojmë. Unë jam krejt konfuz se për çka të votoj. Janë dy materiale, janë dy data, janë krejt konfuze këto gjëra, andaj ju lus që mos të bëjmë çështje pazari këtu, andaj ta lëmë për një seancë tjetër, ju lutem.

KRYESUESI: Dobro. Ja vas molim samo za malo pažnje. Stavljam na glasanje predlog šefa Poslaničke grupe PDK, Ramë Buja.

Pre glasanja, ministar ima reč, izvolite!

NEKIBE KELMENDI: Unë, mendoj se pas miratimit të rendit të ditës nuk mund të diskutohet që një pikë e rendit të hiqet nga rendi i ditës. Është miratuar rendi i ditës.

KRYESUESI: Ja se izvinjavam, mi smo stalno glasali, znači imaju prvo da glasaju. Idemo na glasanje predogom gospodina Ramë Buje.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Poslanički klub LDK, dali ima neko ko će da se izjasni za ovaj predlog? U ime LDK ko će da se izjasni za ovaj predlog? Izvolite! Eqrem Kryeziu, izvolite!

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe për mua nuk është situata e qartë, kështu që e kisha ndërmend të abstenoj fare në qoftë se do të vihej në votim, sepse është e vërtetë që shefat e grupeve parlamentare me mungesën e të dashurit tonë Lutfi Haziri, por të tjerët kanë qenë aty, e kanë pranuar këtë rend dite. Kjo është shumë e vërtetë dhe tani për shkaqe teknike detyrohemi që ta heqim nga shqyrtimi dhe unë besoj se praktikisht këtu faji është pa adresë. Ne po pësojmë se edhe një herë do të duhej ta marrim në shqyrtim këtë projektligj, ndërkaq është një gabim teknik i kujt është, po ka të tjerë që mund ta zbulojnë, kështu që unë për vete në qoftë se ju e veni në votim, do të tregoj se do të abstenoj. Unë po tregoj haptas votën time e këta shokët le të bëjnë çka të donë.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Iz Poslaničke grupe AKR, gospodin Makolli, izvolite!

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me të vërtetë është jo e sinqertë që të fajësohen shefat e grupeve parlamentare për rendin e ditës. Rendi e ditës, sikurse e dimë e harton Kryesia e Kuvendit dhe Kryesia e Kuvendit do të duhej që këto materiale t'i ketë para vetes, para se t'i ofrojë për seancë.

Ne po flasim për dy dokumente të ndryshme, ma thoni dikush se për cilin dokument do të votojmë ne tash, nëse votojmë, sepse kemi filluar që të shndërrohemi në diçka jo serioze. Prandaj, gjithsesi, pavarësisht që është miratuar rendi i ditës, kjo pikë e rendit të ditës do të duhej të shtyhet për një mbledhje tjetër dhe po e ripërsëris edhe njëherë ky Kuvend ka nevojë që ngutshëm të debatojë për funksionalizimin e tij të brendshëm.

KRYESUESI: Hvala! Kolege, samo imam potrebu da vam kažem, s obzirom da sam bio na sednici članova Predsedništva gde o dnevnom redu učestvuju zajedno i šefovi poslaničkih grupa. Vi na toj sednici niste bili, da ste bili, možda bi bilo drugačije. Izvolite AAK! Gospodin Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se, nëse kemi dilema se çka po votojmë dhe po duket se kemi dilema se çka po votojmë, mund të tërhiqet edhe pse në mbledhje të Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare është miratuar rendi i ditës. Kjo nuk është arsye që nëse kemi dilema për një amendament ose për një grumbull të amendamenteve të një ligji, që ky ligj të mos tërhiqet. Ne kemi pasur shumë raste tjera, kur një gjë e tillë ka ndodhur edhe mendoj se nuk ka asnjë arsye se sot, duke pasur parasysh këtë dilemë kaq të madhe që e kemi, që të mos tërhiqet edhe njëherë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Šef Poslaničke grupe LDD. Lulzim Zeneli, molim režiju da da mikrofon.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, kryesues!

Së pari pas krejt kësaj çka ka ndodhur, nuk mund të procedohet në këtë formë dhe besoj se duhet t'i jepet kohë, së pari Komisionit për Buxhet, i cili si komision kryesor, duhet ta thotë fjalën e vet për këtë dilemë që e ka. Dhe e dyta, kujtoj se nuk ka mundësi që të

adresohet tutje kjo çështje, në këtë formë- dilemë në çfarë është shtruar deri tash. Prandaj, do të jepet kohë, kohën do ta përcakton vetë sa ka nevojë. Nëse ka mundësi të kryhet brenda ditës sot dhe dy komisionet takohen, do të ishte e rrugës, nëse jo le të procedohet për një seancë tjetër.
Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Poslanički klub 7+, gospodin Sadik Idrizi.

SADIK IDRIZI: Hvala, predsedavajući!

Ja mislim da je dodatnu zabunu stvorila konstatacija da nakon usvajanja dnevnog reda, da ne može da se odloži ova tačka. Mislim da je sasvim normalno da jedna tačka može biti odložena ako se u toku rasprave o toj tački dodje do zaključka da nema nekog rešenja, da se traže dodatne informacije, odnosno dodatna mišljenja komisija. Iz tih razloga, mislim da treba da se odloži i da se za jednu od narednih sednica postavi ponovo i da se to rasvetli, znači mislim zaista treba biti malo ozbiljniji. Hvala!

KRYESUESI: Hvala, poslaniče! Grupa SLS, gospoda Kosara Nikolić, izvolite!

KOSARA NIKOLIĆ: S obzirom da sam i član Komisije za budžet, ja mislim da ovo treba da se vrati ponovo tamo, da iako ne bi bilo nikakve razlike više u amandmanu koji je i sada, nego se tiče samoga načina rada, i mislim da se dnevni red može promeniti, zato što je došlo sada do konstatacije da smo dobili dva različita dokumenta. Ne, ne, sada je stigao jedan, a mi smo ranije imali samo taj, o kome ne možemo da raspravljamo.

KRYESUESI: Hvala, gospoda Nikolić, i kao predsednik Komisije za budžet na kraju, izvolite, kolega Gani Koci ima reč.

GANI KOCI: Zoti kryesues, çështja nuk qëndron te implikimet buxhetore, sepse as në variantin e parë e as në variantin e dytë nuk ka implikime buxhetore. Çështja qëndron në atë se Komisioni ka sjellë rekomandime në bazë të një varianti që nuk po na del valid sot këtu, dhe atëherë unë nuk dua Komisionin tim ta vejë në lajthitje te them po qëndrojnë rekomandimet sipas variantit të parë që nuk është valid, për shkak se qenka ma i mirë ky tjetri. Prandaj, në parim këto rekomandime Komisionit nuk vlejnë, sepse këto rekomandime janë për një raport ose për një dokument që nuk paska qenë valid. Me lejo për dy minuta e bëjmë rekomandimin tjetër pa këtë të shqyrtohet, sqarime edhe kryhet kjo punë. Por të thuhet që është mirë e nuk ka komplikime buxhetore në këtë anë, nuk qëndrojnë arsyetimet aty. Arsyetimet janë, sepse si Komision kemi punuar me një dokument inekzistent, paska ekzistuar. Ky është problemi, dhe në Kuvend është paraqitë një dokument që qenka valid dhe qenka ekzistent, dhe të gjitha komisionet edhe ai i komuniteteve edhe ky i buxhetit paskan punuar me një dokument që nuk qenka dokument i Komisionit funksional dhe u krye.

KRYESUESI: Imamo dva predloga, da odložimo ovu tačku za drugu sednicu, ili da odložimo ovu tačku do kraja ove sednice?

Idemo za prvi predlog, znači prvi predlog je ovakav da Komisija zaseda i da u toku ove Skupštine, kao zadnja tačka dnevnog reda bude na dnevnom redu, ako ne, onda idemo na drugi predlog koji je gospodin Ramë Buja i većina šefova poslaničkih klubova dala.

Idemo na glasanje, idemo na glasanje predloga koji je dao gospodin Ramë Buja i većina šefova poslaničkih klubova dala saglasnost.

Ko je za to da se ova tačka odloži za narednu sednicu?

Molim režiju da se pripremi za glasanje, i glasaćemo elektronski.

Glasamo sada.

Hvala! Glasalo je 59 poslanika od prisutnih 64 poslanika u Sali, 48 su „za“, 3 „protiv“ i 8 uzdržanih.

Znači, odlaže se ova tačka za narednu sednicu Skupštine Kosova.

Idemo na tačku broj sedam dnevnog reda:

- Drugo razmatranje Nacrta zakona o materijalnoj podršci porodicama dece sa stalno organičenim sposobnostima

Ovaj Nacrt zakona je usvojen na prvom čitanju 28. februara 2008. godine. Parlamentarne komisije su razmotrile Nacrt zakona i Skupštini upitile izveštaj sa sledećim preporukama.

Komisija za zakonodavstvo je ocenila da odredbe ovog N/zakona imaju pravnu osnovu prema Ustavnom okviru.

Komisija za prava i interese zajednice je ocenila da odredbe ovog Nacrta zakona i predloženi amandmani ne zadiru u prava i interese zajednica.

Komisija za budžet i financije je ocenila da odredbe ovog Nacrta zakona ne sadrže budžetske implikacije i

Komisija za zdravstvo, rad i socijalno staranje, kao funkcionalna i izvestilačka komisija, razmatrila je Nacrt zakona i preporučila Skupštini njegovo usvajanje sa predloženim amandmanima.

Pre početka glasanja o predloženim amandmanima, pozivam predsednika ili izvestioca funkcionalne komisije, ukoliko želi da obrazloži izveštaj sa preporukama. Podsećam da ovo prvo imaju i predstavnici funkcionalnih komisija.

Koleginica Flora Brovina,izvolite!

FLORA BROVINA: Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, ju lus të gjithë deputetëve të Parlamentit të votojnë për këtë ligj, e amendamente që janë në përmirësim të ligjit që kanë qenë unanimisht të votuara ose me aklamacion dhe besoj që ligji do të shkojë në favor të familjeve dhe fëmijëve që kanë aftësi të kufizuara të rënda.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Da li ima još neko, da li želi još neko reč? Dobro, prelazimo na glasanje i usvajanje predloženih amandmana Funkcionalne komisije prema redosledu i izveštaju.

Idemo, Amandman 1. Molim, izvolite! Kolega Hyseni, režija dajte mikrofona.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit shumë. Meqë pak më parë biseduam për problemet që i hasëm rreth procedimeve që po ndodhin, mendoj që i njëjti gabim është paraqitur edhe te ky ligj, dhe ju lutem, atëherë duhet të kemi kujdes ta kuptojmë drejtë që, ne si deputetë nuk mundemi ta kryejmë edhe punën e administratës, dhe sipas kësaj, del që edhe unë tash si Komision, duhet të kërkoj sepse nuk e kam pas këtë rekomandim e cila nuk ndryshon asgjë në përmbajtje, të njëjtën bazë juridike do ta ketë, mirëpo është proceduar me data të ndryshme. Prandaj, ju lutem le të vlen kjo çështje edhe për këtë ligj, nëse po lëshohemi në formalitete. Është e njëjta çështje, prandaj ju lutem... jo, jo ju lutem nuk ka harmonizim, unë kur e kam marr e kam marr me rekomandim të parë, andaj ju lutem përmirësoni.

KRYESUESI: Ima reč profesor Hamiti.

SABRI HAMITI: Krejt këto procedurale janë, por po bëhen esenciale për shkak se është e vërtetë që kjo legjislaturë ka prurë deputetë shumë për herë të parë dhe nuk është gjë e keqe kjo. Problemi është, këta nuk kanë të drejtë të flasin në Kuvend, sepse e disha që kanë shpjegime sekretari dhe drejtori i administratës. Kjo është procedurë e të gjitha kohërave e legjislaturës. Kjo që e keni në fillim, është finalja e të gjitha propozimeve dhe e keni të krahueshme nenin me pikën e Ligjit që amendamentohet. Kjo është finalja. Kjo që e keni djetas mbrapa, është rekomandimi elementar i Komisionit. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë që pjesa finale mund të përmbajë edhe rekomandime të komisioneve të tjera, mund të përmbajë rekomandime të grupeve parlamentare, mund të individëve, kështu që nuk është e thënë të jenë të njëjta.

Në këtë rast, normalisht, keni kujdes, punohet ky variant që e ka krahpërkrah nenin i cili amendamentohet dhe besoj që në këtë pikë më nuk kemi pse të humbim kohë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Ima reč kolega Adem Hajdari i molim režiju da uključi mikrofoni!

ADEM HAJDARI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha ta marrë fjalën edhe herën e kaluar për Ligjin e përparshëm se jam anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe nuk vepruat mirë kur e shtytë Ligjin edhe pas sqarimeve të ministres së Drejtësisë, e cila ka marrë pjesë në shqyrtimin e Ligjit. Gabimet teknike nuk mund ta shtyjnë ligjin dhe më duket e paarsyeshme që i tërhoqët deputetët që të votojnë kundër, pa e sqaruar mirë çështjen, se ana teknike nuk mund ta shtyjë ligjin për një herë tjetër. E njëjta gjë është, prandaj propozoj të kthehemi e të votojmë edhe për të parin edhe për këtë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Idemo na glasanje:

Amandman 1.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sad:

U Sali je prisutan 61 poslanik.

Za amandman 1. je glasalo 47 poslanika, od toga 46 „za“ i 1 je bio uzdržan.

Amandman 2.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Trenutno u sali ima 59 poslanika. Pozivam poslanike da se vrate u sali kako bi imali kvorum za glasanje.

Kolega Riza Smakaj je tražio reč. Mada nema kvoruma, izvolite!

RIZA SMAKAJ: I nderuari, zotri kryesues,
Kolegë të nderuar,
Absolutisht nuk është në rregull, nuk po e them me numër se nuk po di, me dhjetëra deputetë të Kuvendit të Kosovës, në vend që të rrinë në vendet e tyre për ku janë zgjedhur, të rrinë nëpër holle, e këtu ta vejmë në pikëpyetje kuorumin që nuk është vlerësim i mirë, i pranueshëm e i lejueshëm për deputetin. Deputeti mund të mungojë me shkak të arsyeshëm, e jo me arsye. Kjo mendoj se nuk është në rregull dhe me plotë kompetencë ia adresoj qortimin cilido qoftë, pa marrë parasysh. Kjo vlen aq më tepër për ministrat, të cilët nuk i përfillin deputetët, nuk e përfillin Kuvendin, nuk e përfillin popullin i cili i ka votuar. Trajtohen temat që u referohen ministrave, e ata me duar në xhepa dalin, hyjnë etj. etj.

Prandaj unë e mbështes idenë e zotëri Makollit, që një pikë e rendit të ditës e Kuvendit të jetë pikërisht kjo tematikë. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Hvala kolega! Vraća se AKR na svoja mesta i mislim da... Evo, molim vas, samo za malo tišine. U Sali je prisutno 63 poslanika, što znači da imamo kvorum. Molim da se pripremimo za glasanje za amandman broj 2.

Režija neka se pripremi za glasanje.

Glasamo sada. Izvolite!

Glasalo je 54 poslanika, od toga 50 „za“, 4 uzdržanih.

Idemo dalje

Stavljam na glasanje Amandman br. 3.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasali su 50 poslanika, svih 50 „za“.

Idemo dalje. Stavljam na glasanje Amandman 4.

Molim režiju za glasanje.

Glasamo sada:

Glasalo je 60 poslanika, od toga 59 „za“, 1 uzdržan. Konstatujem da je amandman prihvaćen.

Amandman br.5

Molim režiju da se pripremi za glasanje

Glasamo sada:

Zahvaljujem se. Glasalo je 61 poslanik, 58 „za“ 3 uzdržana.

Amandman 6.

Stavljam na glasanje, molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se. Glasalo je 63 poslanika, 61 „za“, 2 uzdržana. U Sali je prisutno 69 poslanika. Konstatujem da je amandman br. 6 prihvaćen.

Amandman br.7

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 64 poslanika. 62 „za“, 2 uzdržana.

Stavim na glasanje Amandman br. 8.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 65 poslanika, 64 „za“, 1 uzdržan.

Idemo na Amandman br. 9.

Stavljam na glasanje amandman br. 9.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 66. poslanika, 64 „za“, 2 uzdržana. Konstatujem da je amandman 9 prošao.

Idemo na Amandman br. 10.

Stavljam na glasanje Amandman 10.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 64 poslanika, 63 „za“, 1 uzdržan.

Idemo na Amandman br. 11.

Stavljam na glasanje Amandman br. 11.

Molim režiju da se pripremi glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 65 poslanika, 64 je glasalo „za“, 1 je uzdržan.

Konstatujem da amandman prošao.

Idemo na Amandman br.12

Stavljam na glasanje.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Zahvaljujem se! Glasalo je 64 poslanika, 62 „za“ i 2 su uzdržana.

Konstatujem da je amandman br. 12 prošao u načelu.

Idemo na Amandman 13.

Stavljam na glasanje Amandman br. 13.

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 67 poslanika, 65 „za“, 2 uzdržana.

Stavljam na glasanje Amandman br. 14

Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! 65 poslanika je glasalo, 63 je glasalo „za“, 2 su uzdržana.

Konstatujem da je amandman broj 14 prošao.

Idemo na Amandman br.15

Stavljam na glasanje Amandman 15.

Molim režiju da pripremi glasanje.

Glasamo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 67 poslanika, 66 je „za“, 1 je uzdržan.

Konstatujem da je Amandman 15 prošao.

Molim poslanike i režiju da se pripreme za glasanje teksta Nacrta zakona u celini, uz usvojene amandmane. Glasamo sada:

Zahvaljujem se!

Konstatujem da je sa 64 glasova „za“, nijedan „protiv“ i 1 uzdržan, Skupština usvojila Zakon o materijalnoj podršci porodicama dece sa stalnim ograničenim sposobnostima.

Zahvaljujem se.

Idemo tačku 8 dnevnog reda:

- Drugo razmatranje Nacrta zakona o civilnoj upotrebi eksploziva

Ovaj nacrt zakona je usvojen na prvom čitanju 26. februara 2006.godine.

Parlamentarne komisije su razmatrale Nacrt zakona i Skupštini uputile izveštaje sa sledećim preporukama:

- Komisija za zakonodavstvo, ocenila je da odredbe ovog zakona imaju pravnu osnovu prema Ustavnom okviru;
- Komisija za prava i interese zajednica, ocenila je da odredbe ovog nacrta zakona i predloženi amandmani ne naziru u prava i interese zajednice;
- Komisija za budžet i finansije je ocenila da odredbe ovog nacrta zakona ne sadrže budžetske implikacije, i
- Komisija za unutrašnje poslove i bezbednost, kao funkcionalna i izvestilačka komisija, razmotrila je Nacrt zakona i preporučila Skupštini njegovo usvajanje sa predloženim amandmanima.

Pre početka glasanja predloženih amandmana, pozivam predsednika ili izvestioca Komisije, ukoliko želi, da obrazloži izveštaje sa preporukama.

Podsećam da ovo pravo imaju i predsednici funkcionalnih komisija.

Izgleda, nema prijavljenih.

Pošto nema prijavljenih za reč, idemo dalje.

Prelazimo na glasanje predloženih amandmana funkcionalne komisije prema redosledu.

Amandman 1.

Stavljam predloženi amandman na glasanje.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Zahvaljujem se!

Prisutni su 66 poslanika u sali. 57 je glasalo „za“.

Amandman 2.

Stavljam predloženi amandman na glasanje.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Zahvaljujem se!

Glasalo je 58 poslanika i svih 58 su glasali „za“ i konstatujem da je prihvaćen amandman.

Amandman 3.

Stavljam na glasanje amandman 3 i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sad.

Zahvaljujem se! Glasalo je 59 poslanika, od ukupno 66 prisutnih u Sali, 58 je glasalo „za“ i 1 je uzdržan i konstatujem da je amandman 3 prihvaćen.

Amandman 4.

Stavljam na glasanje amandman 4 i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 62 poslanika i svih 66 poslanika je glasalo „za“.

Amandman 5.

Imamo jednu primedbu na amandman 5.

Poštovani poslanici, napominjem da je došlo do tehničke greške u redosledu amandmana u tekstu na albanskom jeziku, tako da naredni amandman je amandman broj 5. a ne 4. kao što je u redosledu.

Znači, sada glasamo za amandman 5.

Stavljam na glasanje amandman 5. Molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasajmo sada:

Zahvaljujem se! Glasalo je 60 poslanika, 51 je „za“, 1 uzdržan. Konstatujem da je amandman 5. prihvaćen.

Stavljam amandman 6. na glasanje i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasamo sada:

U sali je prisutno 63 poslanika, od toga 57 je glasalo „za“ i konstatujem da je prihvaćen amandman 6.

Idemo na Amandman 7.

Stavljam na glasanje amandman 7 i molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasajmo sada:

Glasalo je 59 poslanika, svih 59 je glasalo „za“ i konstatujem da je amandman 7 prošao.

Amandman 8.

Stavljam na glasanje amandman 8 i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Za amandman 8 glasalo je 58 poslanika i svih 58 je glasalo „za“.

Amandman 9.

Stavljam na glasanje amandman 9 i molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasajmo sada:

Glasalo je 61 poslanik, 60 je glasalo „za“, 1 uzdržan i konstatujem da je amandman 9. usvojen.

Amandman 10.

Stavljam na glasanje amandman 10. i molim režiju da se pripremi za glasanje.

Glasajmo sada:

Za amandman 10. glasalo je 63 poslanika, 62 „za“ i 1 uzdržan. Konstatujem da je amandman 10 prošao.

Amandman 11.

Stavljam na glasanje amandman 11. Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Za amandman 11. glasalo je 60 poslanika, 50 „za“, 1 uzdržan i konstatujem da je amandman 11. prošao.

Amandman 12.

Stavljam na glasanje amandman 12. Glasajmo sada:

Za amandman 12. glasalo je 58 poslanika, 57 „za“, 1 zdržan i konstatujem da je amandman 12. prihvaćen.

Amandman 13.

Stavljam na glasanje amandman 13. Molim režiju da bude spremna za glasanje. Glasajmo sad:

Glasalo je 62 poslanika, 59 „za“, 2 „protiv“, 1 uzdržan. Konstatujem da je amandman 13 usvojen.

Amandman 14.

Stavljam na glasanje amandman 14. Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sad:

Glasalo je 64 poslanika, 62 je glasalo „za“, 2 uzdržana i konstatujem da je amandman 14 usvojen.

Amandman 15.

Stavljam na glasanje amandman 15. Glasajmo sad:

Glasalo je 61 poslanik i svih 61 je glasalo „za“ i konstatujem da je amandman 15. usvojen.

Amandman 16.

Stavljam na glasanje amandman 16. Glasajmo sada:

Glasalo je 68 poslanika, 67 je glasalo „za“, 1 je protiv i konstatujem da je amandman 16. usvojen.

Amandman 17.

Stavljam na glasanje amandman 17. Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada: Hvala!

Glasalo je 61 poslanik, 61 je glasalo „za“ i konstatujem da je amandman 17. usvojen.

Amandman 18.

Stavljam na glasanje amandman 18. i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Glasalo je 68 poslanika za amandman 18. i svih 68 je glasalo „za“. Konstatujem da je amandman 18 prošao.

Amandman 19.

Stavljam na glasanje amandman 19. Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada:

Glasalo je 65 poslanika i svih 65 je glasalo „za“. Konstatujem da je amandman 19. prošao.

Amandman 20.

Stavljam na glasanje amandman 20. i molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada. Hvala!

Glasalo je 62 poslanika i svih 62 je glasalo „za“. Konstatujem da je amandman 20. prošao.

Sada molim poslanike i režiju da se pripreme za glasanje teksta Nacrta zakona u celini, uz usvojene amandmane.

Molim režiju da se pripremi za glasanje. Glasajmo sada. Zahvaljujem se!

Konstatujem da je sa 69 glasova „za“ i nijedan protiv Skupština usvojila Zakon o civilnoj upotrebi eksploziva.
Zahvaljujem se!

Prelazimo na tačku 9. dnevnog reda:

- Razmatranje preporuke Komisije za Budžet i finansije o prosljedjivanju Nacrta zakona o sprečavanju pranja novca

Usvajanje u načelu Nacrta zakona o sprečavanju pranja novca je učinjeno 26. 2. 2008. godine.

Funkcionalna komisija – Komisija za budžet i finansije razmotrila je i Skupštini dostavila izveštaj sa preporukama da se Nacrt zakona vraća Vladi na doradu.

Preporuka Komisije je dostavljena poslanicima.

Pozivam predstavnika ili izvestioca funkcionalne komisije, gospodina Gani Kocija da obrazloži izveštaj sa preporukama.

Izvolite gospodine Koci!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Vërtet, bukur gjatë jemi marrë me këtë projektligj dhe po i ngjan asaj që thuhet një odisejade kështu shumë të gjatë dhe pa përfundim.

Sipas kreut 9.1.10 dhe 9.1.36 të Kornizës kushtetuese dhe Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni, pas disa mbledhjeve që ka mbajtur prej momentit të shqyrtimit të parë të këtij projektligji e deri te këto rekomandime, ka ardhur në përfundim dhe përfundimi i këtij komisioni janë këto rekomandime, të cilat edhe ju i keni pasur sigurisht përpara dhe i keni lexuar, me një arsyetim të shkurtër, si vijon:

Komisioni për buxhet dhe financa, pas shqyrtimit përfundimtar të Projektligjit dhe të amendamenteve të veta, në konsultim dhe sugjerim të ekspertëve ndërkombëtar nga vendet respektive, që kanë eksperiencë të duhur legislative dhe praktikë të luftimit të pastrimit të parave, ka vlerësuar të nevojshme tërheqjen e këtij Projektligji për

parandalimin e pastrimit të parasë nga procedura e rregullt e shqyrtimit të mëtutjeshëm të Kuvendit.

Ne, në Kuvend nuk kemi pasur një praktikë të tillë të tërheqjes në leximin e dytë të projektligjeve dhe ndoshta këtu mund të kemi një dilemë në aspektin e procedurave dhe të rregullave të Kuvendit, sepse mund të jetë një zbrazësi se çka në qoftë se nuk mund të miratohen. Ne kemi Rregullën atje të leximit të tretë, që ne edhe mund të mos e votojmë në leximin e dytë e të shkojmë me leximin e tretë, por duke pasur parasysh se këtij ligji duhet hyrë prej fillimit, atëherë as leximi i tretë nuk do të sjellë rezultate të duhura në realizimin e këtij ligji.

Prandaj, Komisioni kërkon nga Kuvendi që këtë projektligj, mbi bazë të sugjerimeve që i kemi marrë edhe prej ekspertëve, ose prej zyrave respektive, për çka kemi pasur disa takime me ta si Komision, dhe në mbledhjen e fundit të Komisionit i kemi pasur prezent dhe kemi edhe letra korresponduese me këto zyra që kanë kërkuar në mënyrë decitive të tërheqim këtë projektligj dhe t'i dërgohet Qeverisë, respektivisht Ministrisë përkatëse, në mënyrë që ata, në procesin që nga fillimi, të bëjnë një ligj që do t'i përshtatet kohës dhe rrethanave të cilat si Kosovë i kemi pas 17 shkurtit 2008.

Dihet se është dorëzuar shumë herët ky Projektligj në mandatin e kaluar në Kuvend dhe ka arritur edhe të amendohet si Projektligj, por s'ka arritur të realizohet dhe të miratohet në Kuvend. Ne, si të tillë, kemi punuar me mundësitë tona, duke përmirësuar ato amendamente e duke shtuar edhe amendamente tjera dhe të gjitha ato amendamente i kemi dorëzuar nëpër qendra, të cilat janë interesuar rreth këtij projektligji dhe të gjitha sugjerimet dhe shkresat e tyre kanë qenë që ky t'i kthehet Qeverisë dhe ne, si Komision, në mbledhjen e fundit kemi vendosur t'i propozojmë Kuvendit që të marrë një vendim lidhur me tërheqjen e këtij projektligji dhe ta kthejmë në Qeveri për ta punuar një ligj të ri rreth kësaj çështjeje, për të cilën ne po diskutojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, kolega Koci! Pozivam šefove poslaničkih klubova ili predstavnike da uzmu reč.

Želi li ko reč? Poslanički klub LDK?

Ima reč Safete Hadërgjonaj, predstavnik Poslaničkog kluba PDK. Izvolite!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

E nderuar zonja ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave rregullon një çështje mjaft problematike në lëmin e financave.

Pastrimi i parave kërcnon zhvillimin ekonomik dhe krijon një klimë të përshtatshme për krim të organizuar dhe korrupsion. Një ligj i mirë do t'u ndihmojë autoriteteve përgjegjëse të luftojnë krimin ekonomik-financiar dhe njëkohësisht i pengon edhe bizneset e dëshimta.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se nuk duhet të futemi në inflacion ligjor e pastaj ligji të jetë i pazbatueshëm dhe të mos ketë kurrfarë efekti në stabilizimin e sistemit ekonomik dhe financiar.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa që Projektligji për pastrimin e parave t'i kthehet propozuesit për t'u bërë plotësime të nevojshme dhe Projektligji t'u përshtatet standardeve ndërkombëtare, të mos iu referohet strukturave të cilat, në fakt, nuk ekzistojnë, por t'u përshtatet rrethanave të reja pas shpalljes së Kosovës shtet të pavarur.

Meqenëse futja e parave të pista e dëmton zhvillimin ekonomik të vendit, dëmton bizneset e ligjshme, dëmton sistemin tatimor, nxit rritjen e ekonomisë informale, nxit korrupsionin, financimet e fshehta dhe – çka është më kryesore – e dëmton shtetin ligjor, i sugjerojmë Qeverisë që ta hartojë projektligjin e ri për parandalimin e pastrimit të parave në harmoni me standardet ndërkombëtare, që do të jetë i zbatueshëm dhe në afat sa më të shkurtër t'ia procedojë Kuvendit për shqyrtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, koleginice! Poslanički klub LDK? Ima reč, poslanik Haki Shatri. Izvolite!

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mbështet propozimin e Komisionit për Buxhet për ta tërhequr Projektligjin dhe mendon se me këtë i jep Qeverisë mundësi që, në kuadër të rrethanave dhe të kompetencave të reja që do të kenë institucionet vendore pas 17 shkurtit dhe në veçanti pas 15 qershorit, ligji të jetë më gjithëpërfshirës dhe më kompetent. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Poslanički klub AKR? Kolega Demalijaj. Izvolite!

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit!

Edhe unë, si anëtar i Komisionit dhe njëherësh edhe anëtar i Grupit Parlamentar, bashkë me Komisionin kemi vendosur ta përkrahim kthimin përsëri të këtij projektligji në Ministri.

KRYESUESI: Hvala! AAK? Ima reč, gospodin Ardian Gjini. Izvolite kolega Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sikur edhe përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare, edhe ne pajtohemi që ky ligj të tërhiqet, por vetëm dëshiroj ta vë theksin në atë që kemi përmendur disa herë se ligjet kanë ardhur në pako, ashtu si janë gjend, dhe paramendoni sa shumë kohë ka humbur Kuvendi me këtë ligj dhe tani, prapë se prapë vijmë në pikë që ligji të kthehet komplet prej nga ka ardhur. Kjo kishte për të qenë vetëm një nënvizim i asaj që është thënë disa herë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Poslanički klub LDD, koleginica Besa Gaxherri. Izvolite!

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Natyrisht, duke pasur parasysh këtë ligj, që vërtet është shumë i rëndësishëm, sidomos për fushën e zhvillimit të ekonomisë, pra dhe duke pasur parasysh ekonominë e zezë në Kosovë, ky ligj është më se i domosdoshëm, por edhe duke pasur parasysh se ky ligj që nga mandati i kaluar është ardhur në Kuvend e po kthehet prapë, që për mendimin tim dhe të Grupit parlamentar është krejt i paarsyeshëm që ky Kuvend, realisht Qeveria, në

radhë të parë – nuk ka qenë në gjendje ta hartojë dhe sjellë në Kuvendin e Kosovës dhe ne, natyrisht, si komision funksional i buxhetit, nuk kemi qenë në gjendje që në kohën e caktuar ta kthejmë ligjin dhe të mos vijmë në këtë situatë që kemi ardhur.

Megjithatë, edhe pse të gjitha grupet parlamentare përkrahën që të tërhiqet ky ligj, unë për veten time nuk e shoh këtë të arsyeshme, duke pasur parasysh se ky ligj vërtet është shumë i rëndësishëm për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se koleginici! Poslanička grupa „7+“, koleginica Mufera Shinik.

Teşekkür ederim. Kosova Cumhuriyetinin böyle bir Yasaya ihtiyacının varolduğunu gözönünde bulundurarak, biz de 7+ Parlamenter grubu olarak diğer Parlamenter gruplarıyla birlikte, bu Yasanın yeniden işlenmesine gidilmesini öneriyoruz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Zahvaljujem se! SLS? Gospodja Nikolić Kosara.

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pozdrav svim poslanicima!

Poslanički klub SLS je takodje saglasan da se zakon vrati, s obzirom da se radi o veoma važnom zakonu o sprečavanju pranja novca i zbog izvršenih konsultacija sa stručnjacima – merodavnim iz te oblasti.

KRYESUESI: Zahvaljujem se!

Ako nema prijavljenih za reč, molim poslanike i režiju da se pripreme za glasanje. Glasajmo sada. Hvala!

Glasalo je 61 poslanik, 53 su „za“, 1 „protiv“ i 7 uzdržanih.

Konstatujem da sa 53 glasova „za“, 1 „protiv“ i 7 udrzanih, Skupština je odlučila da Nacrt zakona o sprečavanju pranja novca vraća Vladi na doradi, odnosno ne usvaja se.

Zahvaljujem se! Koristim priliku da pozdravim zamenika premijera, gospodina Kuçi.

Idemo na tačku 10 dnevnog reda:

- Razmatranje predloga Vlade o imenovanju člana Borda Centralnog bankarskog autoriteta Republike Kosova

Vlada Republike Kosova je, u skladu sa članom 18. Uredbe UNMIK-a, br. 006/47, za Centralni bankarski autoritet Kosova predložila kandidata Sejdi Rexhepi za člana Borda Centralnog bankarskog autoriteta Republike Kosova.

Ja vas molim za malu pažnju.

Predlog Odluke Vlade, uz biografske podatke predloženog kandidata, gospodina Sejdi Rexhepi, dostavljen je poslanicima.

Predstavnik Vlade, Profesor Kuçi, imate reč. Izvolite!

HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të prezantoj propozimin për zotin Sejdi Rexhepi, profesor-doktor i ekonomisë, për anëtar të Bordit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës.

Besoj se propozimin e keni marrë me kohë e po ashtu edhe biografinë e tij. Shkurtimisht dua të them se propozimi i zotit Sejdi Rexhepi ka ardhur në Qeverinë e Kosovës dhe më pastaj është miratuar, me konsensus, në Qeverinë e Kosovës dhe pastaj i është dërguar Kuvendit të Kosovës për miratim.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ju lus, të nderuar deputetë, që ta jepni pëlqimin dhe përkrahjen për t'u zgjedhur profesor Sejdi Rexhepi në këtë post. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala, gospodine zameniče premijera! Reč imaju šefovi poslaničkih klubova, ili predstavnici poslaničkih grupa. Poslanik Poslaničkog kluba PDK? Gospodin Ramë Buja, izvolite!

RAMË BUJA: Ne, natyrisht, mbështesim këtë propozim të Qeverisë dhe jemi “për” dhe do të dëshmojmë tash me votën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Hvala! Poslanik LDK-a?

EQREM KRYEZIU: Unë e kam nderin t'i rikthehem funksionit tim, si shef i Grupit dhe me këtë rast, natyrisht, do t'i japim shans propozimit të Qeverisë që të tregojë performansën e vet i propozuari i tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Hvala kolega! Idemo sa AKR? Gospodin Makoli, izvolite!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë,

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e mbështet propozimin e Qeverisë dhe do të deklarohet për propozimin në fjalë.

KRYESUESI: Zahvaljujem se kolega! Iz AAK, gospodjin Gjini, izvolite!

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk mbështet propozimin e Qeverisë dhe nuk e voton. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Poslanik LDD? Izvolite, poslanik Ramosaj!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, duke shqyrtuar propozimin e dhënë, del me një konstatim se, vërtet, nëse dëshirojmë të ndërtojmë institucione të pavarura, sikur që është Autoriteti i bankave të Kosovës, që pretendon të jetë vërtet bankë nacionale, nuk duron involvim politik.

Kolegu i nderuar është një përfaqësues i partisë politike - Partisë Demokratike të Kosovës, i cili është edhe anëtar i Asamblesë Komunale të Prishtinës, sepse në periudhën e kaluar ka qenë dhe më duket se në këtë periudhë është ende.

Prandaj, duke marrë parasysh Bordin e BPK, që llogarisim se do të jetë një bord autoritativ, jo i politizuar, ne mendojmë se vërtet nuk është mirë të politizojmë tërësisht Bordin. Krejt është e mundur që guvernatori, respektivisht kryetari i Bordit mund të jetë nga partia që është në pushtet, por anëtarët e bordit, në qoftë se vërtet dëshironi të luani rolin e ndërtimit të institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura, nuk është e udhës të jenë të politizuar. Andaj, vërejtja ime nuk është e natyrës personale për kolegun e nderuar, por është e natyrës politike, andaj nuk e përkrahim, duke marrë parasysh se zoti Sejdiu është jo vetëm anëtar, por edhe funksionar në Partinë Demokratike të Kosovës, respektivisht deputet në Asamblenë Komunale. Faleminderit për mirëkuptim!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Reč ima zamenik premijera Vlade, gospodin Kuçi.

HAJREDIN KUČI: Faleminderit, zoti profesor!

Mendoj se, zotin Sejdi Rexhepi, kolegun tuaj të fakultetit dhe të Universitetit, besoj e njihni mirë dhe në aspektin profesional nuk keni vërejtje. Kjo është një shenjë e mirë. Përndryshe, zoti Rexhepi, s'di a jeni njoftuar me kohë, ka dhënë dorëheqje nga të gjitha pozicionet e tij. Ai momentalisht është edhe anëtar i Komisionit të përkohshëm të Rregullatorit të KRPP dhe besoj se nga të gjitha pozicionet e tij, qoftë politike, qoftë tjera, me përjashtim që me ligj i lejohet të jetë profesor, ka dhënë dorëheqje.

KRYESUESI: Izvolite, za repliku se javlja kolega Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Pa dashur të polemizoj me zëvendëskryeministrin, desha t'i them se, unë mendoj se Bordi i Autoritetit Qendror të Bankave duhet të ketë rolin e një bordi që më shumë e ka kuptimin e një autoriteti të pavarur e jo të nivelit..., pa marrë parasysh, ne kemi plot profesorë të Universitetit që janë edhe udhëheqës të partive politike. Mirëpo, duke marrë parasysh se vërtet është i politizuar, mendoj që propozimi i PDK-së, në këtë rast edhe i zëvendëskryeministrit, është një propozim partizan që ka kuptimin e komunikimit me një institucion që pretendojmë ta ndërtojmë si bankë qendrore. Prapë po e them, sa i përket përzgjedhjes së profesurës së tij, ka përgjegjësi universiteti, respektivisht rezentët, por këtu, meqenëse kërkohet vota e deputetëve të Parlamentit të Kosovës, unë e mbroj qëndrimin tim se vërtet nuk ishte dashur që Bordi i BPK të jetë i politizuar. Edhe njëherë e mbroj këtë qëndrim dhe besoj se kam të drejtë, andaj kërkoj mirëkuptim edhe nga Qeveria, kërkoj mirëkuptim edhe nga anëtarët apo deputetët e Parlamentit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Zahvaljujem se! Poslanik Grupe "7+", Džezair Murati. Izvolite!

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine prededavajući!

Pozdrav zameniku premijera, ministrima i kolegama,

Mi se pridružujemo parlamentarnim grupama koje podržavaju predlog za izbor člana Centralnog bankarskog autoriteta, smatrajući da je on izvagan pre nego što je došao do ovakvog rešenja. Hvala vam!

KRYESUESI: Zahvaljujem se kolega! Poslanički klub SLS, gospodja Nikolić. Izvolite!

KOSARA NIKOLIĆ: Poslanički klub SLS takodje podržava predlog gospodina za člana.

KRYESUESI: Zahvaljujem se kolegini! Reč je tražio kolega Driton Tali. Izvolite!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha t'i them disa fjalë për këtë propozim, ndonëse personin në fjalë, sinjerisht nuk e njoh. Nuk po them se të gjithë ekonomistët i njoh, por shumicën dhe më të dalluarit i njoh. Për ndryshim nga guvernatori, të cilin kjo Qeveri na e ka servuar dhe koalicioni e votoi, ky megjithatë qenka ekonomist, nuk qenka monetarist apo makro-ekonomist, qenka kontabilist, që megjithatë u afrohet, diku, atyre kërkesave që duhet t'i ketë personi udhëheqës apo personi me rëndësi në Bankën Qendrore.

Jam kundër ndikimeve politike në Bankën Qendrore, nëse dëshirojmë ta kemi një bankë qendrore të mirëfilltë. Këtu e kam skepticizmin tim. Përndryshe, po them edhe njëherë, në krahasim me guvernatorin, të cilin e bajshi me të shëndoshë – e ka votuar koalicioni qeveritar. Ky më i keq s'është. Do të jetë pak më i mirë. Besoj se nuk janë kushëri! Po them, të paktën, ka një background akademik dhe, po shoh, është kontabilist dhe është afër monetaristit, është afër makro-ekonomistit. Por, nëse jep dorëheqje nga PDK-ja, do ta përkrahi edhe më shumë. Kështu, le t'i mbetet atij dhe partisë.

KRYESUESI: Zahvaljujem se gospodinu Tali. Za reč se javio poslanik Haki Shatri. Izvolite!

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni që, me gjithë respektin që kam për kandidatin, sepse e njoh dhe di që është në Bordin e KRPP-së, është një anëtar me vlerë në këtë bord. Unë dua t'ua tërheq vëmendjen deputetëve të Kuvendit para se të votojnë për anëtarin e Bordit të Bankës Qendrore që Ligji për autoritetet qendror të bankave me një nen të veçantë parasheh kriteret për anëtarin e bordit qendror të autoritetit të bankave. Dyshoj se ky kandidat i plotëson ato kriteret. Me gjithë respektin, po e përsëris, për kandidatin, ato kriteret më duket që nuk janë të përmbushura me këtë kandidat, edhe pse biografia e tij është mjaft e pasur në sfera tjera. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Hvala kolega Shatri! Za reč se javio poslanik Riza Smaka. Izvolite!

RIZA SMAKA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qeveritarë, deputetë,

Në kontekstin me propozimin konkret, unë do ta kisha shfrytëzuar këtë oportunitet që në një mbledhje të ardhshme, mundësisht zotëri zëvendëskryeministri Kuçi apo Manaj ose kushdo i autorizuar, ministri për Financa e tjera e tjera, para këtij Kuvendi të prezantojë se sa është paga e anëtarit të Bordit, në këtë rast të Autoritetit Bankar, por edhe të bordeve të tjera. Ato janë para publike, nga buxheti dhe nga populli janë ato para.

Kam indikacione se ato janë marramendësisht të larta, në disproporcionalitet me punën që e bëjnë dhe as përafërsisht puna e cilitdo nuk e justifikon pagën aq të lartë, aq më parë kur shpeshherë thuhet, bile-bile me arrogancë, se ato pagat e tyre janë sekrete. Nuk mund të jenë sekrete paratë publike. Mund të jenë private dhe le të jenë ato marramendësisht të larta, ato absolutisht nuk më interesojnë ato si deputet, por më intereson jashtëzakonisht shumë dhe jam i bindur se edhe ju, zotëri kryesues, dhe cilitdo ministër përkatësisht zëvendëskryeministër e Kryeministër, e deputetë, na intereson dhe ne nuk mund të jemi

indolentë dhe s'mund të jemi indiferentë që të ndërtojnë kritere në kundërshtim me moralitetin, ju lutem, dhe me parimin e punës e të rezultateve të efikasitetit në punë për disa grupe të ngushta që në këtë rast domethënë 10-12-13 veta ndërtojnë dhe miratojnë akte të ndryshme për paga, kompensime e tjera, e tjera.

Prandaj, ju lus, sepse këtë çështje e shtroj parimisht në këtë rast. Faleminderit shumë!

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra dhe ju, kolegë deputetë,

Po habitem shumë nga disa diskutues këtu, të cilët po vënë në dyshim integritetin profesional e moral të kandidatit të cilin e kemi këtu për votim. Kurse, sa i përket përkatësisë partiake, unë mund t'ju them se në Kosovë pak gjenden profesorë ose ekspertë të cilët nuk kanë kaluar nëpër ndonjë parti politike, duke u nisur prej lidhjes komuniste e deri te partitë tash të reja që janë. Në rast se ky kandidat ka dhënë dorëheqje prej partisë politike, ma merr mendja se ai i plotëson kriteret që të zgjedhet dhe votohet në këtë vend për këtë post. Përndryshe, do të detyrohen ekspertët tanë të shkojnë jashtë të kërkojnë punë, në Gjermani ose në Zvicër dhe nuk do të kenë mundësi ata të japin kontributin e tyre nëse nuk punojnë në Kosovë. Prandaj, ju kisha lutur të votohet zoti Sejdiu e të shkojmë përpara.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi. Ata që e kanë marrë fjalën më parë, s'mund ta kërkojnë prapë fjalën me këtë rast.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritet, zoti zëvendëskryeministër, ministra, deputetë,

Unë jo për të interferuar për qëndrimet e secilit prej jush lidhur me kandidatin që është propozuar të jetë anëtar i Bordit, por e njoh personalisht dhe dua t'i them disa fjalë për vlerat e tij profesionale akademike. Është profesor i rregullt në Departamentin e Shkencave Politike për lëndët ekonomike, është njëri nga punëtorët më të vyeshëm aty, është prodekan i fakultetit aktualisht, që do të thotë se edhe me ligjet në fuqi nuk i lejohet përkatësia në parti politike dhe së paku, në strukturat e larta të partisë. Do të thotë është momentalisht pa parti me siguri meqë është në atë pozitë dhe mendoj se është propozim shumë më i qëlluar se propozimi për kryetarin e Bordit që e kishim ditë më parë. Faleminderit!

KRYETARI: Për fjalë është paraqitur Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Desha t'ju them vetëm dy-tri fjalë lidhur me propozimin, i cili na ka ardhur për Bordin e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës. Ne, në vazhdimësi kemi votuar kandidatë të cilët kanë qenë pretendentë për borde të caktuara dhe duhet të jemi shumë të kënaqur ne, si Kuvend, që sot ta miratojmë kandidatin çfarë na është ofruar, sepse ne kemi pasur fat të keq që të votojmë zakonisht kandidatë të cilët fare nuk e kanë merituar të jenë nëpër borde të caktuara, kandidatë politikë dhe me asnjë grimë profesionalizmi, kurse kandidati, i cili na është ofruar për ta votuar kësaj radhe e ka edhe biografinë mjaft të

pasur profesionale dhe çka është më kryesore, kudo që ka punuar, nëpër atë CV që e shohim në materialin që na është ofruar, e ka dëshmuar veten se është një professionalist i mirë dhe nuk është person i korruptuar në një mënyrë apo në mënyrë tjetër, dhe ia vlen të jetë në një bord që është tepër profesional dhe tepër i rëndësishëm për të ardhmen. Ju lutem, ne kemi votuar kandidatë të cilët kanë qenë të zhytur në korrupsion, kurse sot dimë të flasim për kandidatë të cilët janë me një background mjaft të pasur profesional.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

Unë nuk e kam ndërmend të jap kurrfarë mendimi specifik për kandidatin. E njohim, sepse e kemi zgjedhur në KRPP vetë. Unë kam qenë në legjislaturat e kaluara kur është zgjedhur. Kurrfarë mendimi kaq superlativ njerëzit nuk kanë dhënë atëherë për të, për Rexhepin. Por, unë e mora fjalën, që të them krejt diçka tjetër.

Zoti Kryetar, zotërinj të tjerë deputetë dhe anëtarë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që jeni këtu, ju e dini çfarë zhurme keni bërë para do mbledhjesh për një raport të këtij organi, të cilin e keni shtyrë, s'e keni aprovuar dhe sot e kësaj dite Qeveria s'ka dhënë mendim, ka thënë: nuk do të diskutohet pa dhënë mendim. Anëtar i këtij organi, është ky njeri. Mund të jetë më i miri i këtij organi, mund të jetë i mesëm ose më i keqi. Unë nuk e di, por po ju them për t'u bërë serioz në punët që bëjmë: pse atëherë është shtyrë që të votohet ai raport i këtij organi, pse Qeveria ka kërkuar të shtyhet dhe s'ka dhënë mendim, dhe pse ngutet tash ta kalojë në një bord tjetër.

Këto janë pyetjet e mia. Faleminderit shumë zotëri, Kryetar i Kuvendit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Kuçi e ka fjalën.

HAJREDIN KUÇI: Zoti profesor Hamiti ndoshta më nxiti të diskutoj. E para, reagimi ynë nuk ka qenë individual ndaj askujt atë ditë, ka qenë parimor dhe ligjor. Nuk kemi pasur iluzione se dikush është engjëll atje apo edhe dikush që është i inkriminuar, por kemi dashur ta kemi një rend, ta kemi një raport nga Qeveria, ta kemi një raport nga komisioni dhe pastaj të diskutohet. Ky ka qenë rendi dhe besoj këtë rend duhet ta ndjekim.

Në anën tjetër, ne nuk mund të supozojmë asnjëherë për një njeri derisa nuk është vendim i prerë i gjykatës se është i fajshëm dhe do të ishte jonjerëzore, jolegale dhe jopolitike nëse do të thoshte Qeveria për dikë tjetër.

Në anën krejt tjetër, secili individ ka nevojë që të zhvendoset ose të kërkojë një pozicion tjetër. Do të ishte jologjike nëse ai nuk do të zhvendosej në një vend sepse edhe ashtu e dini, mandati është gati në përfundim, por edhe sikur të ishte mandati në fillim, ka të drejtë të konkurrojë dhe të kandidohet. Ka ardhur propozimi nga Qeveria, Qeveria si e tërë, jo si Parti Demokratike që u përmend, në mënyrë unike – me konsensus, nuk e thashë rastësisht fjalën konsensus, sepse besoj kam qenë i vëmendshëm për atë fjalë, e kemi dhënë mendimin dhe propozimin që të votohet në Kuvend. Kualifikime personale nuk ka pasur as atë ditë për anëtarët e KRPP, nuk ka as sot. Procedura legale do të ketë për secilin. Nëse ka bërë ndonjë veprim inkriminues i përmenduri në fjalë, edhe po ta zgjedhim dhe kudo që të zgjedhet, ne s'mund t'ia fshehim atë.

KRYETARI: Faleminderit!

(Reagim nga salla)

Ke të drejtë, e s'ke të drejtë. Urdhëro e merre fjalën! E ka fjalën Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë kam të drejtë me rregullat në fuqi të Parlamentit të përgjigjem në fjalët të cilat kanë të bëjnë edhe me emër e me mbiemër dhe me materiet që i thashë. Edhe unë kam qenë më i kujdesshëm se ndonjëherë në jetën time në formulimet që i thashë pak përpara. Veç, unë as që dua të paragjykoj për vlerat e askujt. Unë thashë, vetëm solla ndërmend evidencën që ka ndodhur në këtë Parlament. Ju po thoni, kemi thënë, kemi kërkuar ligj. Jo, jo, zotëri, ekzistojnë fjalët e shqiptuara në Parlament rreth atij organi dhe ato janë edhe në letër. Kanë qenë fjalë shumë të mëdha, e unë do të thosha shumë të rënda. Unë, vetëm solla në kujtesë këtu. As nuk paragjykoj për vlerat, as për jovlerat. Kaq!

KRYETARI: Nejse, pozita duhet ta shqyrtojë pozicionin e vet. Fjalën e ka Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për atë çka do të flas, është mënyra e qeverisjes për shkak të këtij propozimi dhe konkret, pasi zëvendëskryeministri tha se ka qenë e drejtë ligjore e Qeverisë. Zoti zëvendëskryeministër, ju e dini shumë mirë se KRPP është Agjencion i Pavarur. E ka formuar ky Kuvend, i përgjigjet këtij Kuvendi dhe absolutisht Qeveria nuk ka pasur të drejtë të ndërhyjë atë ditë. Kjo është e para.

E dyta, është se propozimi është parimor, që ne po synojmë të ndërtojmë institucione të pavarura politike, ose me ndikim politik, çka nënkupton se ai nuk duhet të jetë nën ndikimin e PDK-së, siç janë edhe ndërmarrjet, edhe veprimet e tjera, të cilat ju po i bëni dhe po na e cenoni lirinë.

Prandaj, ideja është parimore. Ka konflikt interesi dhe dua t'ia kujtoj, sidomos PDK-së, diskutimet e tyre në mandatin e kaluar, pikërisht në këtë pikë. Në qoftë se ju keni ndryshuar në këtë aspekt, atëherë po ua lë qytetarëve të Kosovës t'ju vlerësojnë. Por, nuk është mirë të punohet në këtë mënyrë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E, pasi ia dhamë fjalën anëtarit të Kryesisë, po ia japim edhe Driton Talit.

DRITON TALI: Zoti Kryetar,

Këtu, po më duket, po merremi me çështje të egos e është dashur të merremi me një institucion shumë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, siç është Banka Qendrore.

Nuk e keni të qartësuar a kemi të bëjmë me atë deri sa ky institucion – Autoriteti i tashëm bankar të shndërrohet në bankë qendrore, që është deri më 15 qershor, apo deri sa të futet në fuqi Kushtetuta. Nëse e votojmë këtë njeri për një muaj ditë, nuk ka kurrfarë problemi, por nëse e votojmë, ashtu siç është votuar edhe guvernatori, që do të ngelin edhe në kohën kur autoriteti bankar shndërrohet në Bankë Qendrore, atëherë unë i kam rezervat e mia me këtë person në kuptimin profesional dhe nuk do ta votoj.

Dhe, po ashtu, në kuptimin e ngjyrave politike, pa keqkuptim, por Banka Qendrore duhet të jetë pa ndikime politike për shkak të rëndësisë që ka në ekonomi, nëse duam ta bëjmë një institucion siç duhet. Nëse duam ta vazhdojmë, ta mëkëmbim, ne mund të bëjmë qysh

duash. Ne e kemi bërë edhe një “cirkusant” guvernator, me plotë gojë po them. Ky, në krahasim me atë “cirkusantin”, të paktën është profesionalist i afërt. Kështu që gjynahet i ka ky Parlament, megjithatë. Pra, të mos merremi me ego personale, sepse kemi të bëjmë me një institucion shumë të rëndësishëm për ardhmërinë e ekonomisë së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të lajmëruar për diskutim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Prezent janë 69 deputetë.

Kanë votuar “për” 43 deputetë, 7 “kundër” dhe 3 abstenime.

Konstatohet se miratohet propozimi i Qeverisë.

Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar deputetin Bujar Bukoshi, anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, për zëvendëskryetar të parë në Komisionin për Integritet Evropian, në vend të deputetit Lutfi Haziri, zëvendëskryetar aktual.

Deputeten Melihate Tërmkolli, anëtare e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, e ka propozuar për anëtar të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, në vend të deputetit Bujar Bukoshi, kurse deputetin Lutfi Haziri, zëvendëskryetar i parë i Komisionit për Integritet Evropian për anëtar të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në vend të deputetes Melihate Tërmkolli.

Tash do ta bëjmë një votim formal, me ngritje dore. Faleminderit!

Kush është “kundër”?

A ka abstenim? Një. Faleminderit!

Konstatohet se propozimi u miratua me shumicën e votave.

Kalojmë në pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i propozimeve të grupeve parlamentare për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Bazuar në përfundimin e Kryesisë, Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar deputetin Gani Koci për anëtar të Këshillit të Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar deputetin Haki Shatri anëtar të Këshillit të Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Nga opozita, Grupi Parlamentar i AKR-së ka propozuar deputeten Suzan Novobërdaliu për anëtare të Këshillit të Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim!

(Reagim nga deputetët)

Ne, në Kryesi kemi diskutuar dhe atëherë ishte propozimi, mendoj edhe propozim i drejtë, që prej këtyre 3 anëtarëve, 2 të jenë nga pozita, 1 nga opozita. Do të thotë, PDK-ja dhe LDK-ja i propozojnë në bazë të koalicionit qeverisës, kurse një është nga opozita. Kështu ka qenë marrëveshja në Kryesi.

(Reagim)

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash. Në sallë janë 75 deputetë, “për” kanë votuar 53, 1 “kundër”, 2 abstenime dhe konstatoj se Kuvendi miratoi propozimin e grupeve parlamentare për emërimin e Gani Kocit, Haki Shatrit dhe Suzan Novobërdaliu për anëtarë të Këshillit Të Agjencionit Kundër Korrupsionit.

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë:

- **Formimi i organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 96 pika 4 të Ligjit për prokurimin publik dhe me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit, ka propozuar 3 gjyqtarë për anëtarë të Organit përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me emrat e 3 anëtarëve iu është shpërndarë deputetëve.

Radhën për diskutim e kanë kryetarët e grupeve parlamentare. Radhën e ka Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

(Ndërhyrje pa kyçje të mikrofonit – nuk dëgjohet për transkriptim)

Nëse nuk ka diskutime nga kryetarët e grupeve, kalojmë në votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Në sallë janë 72 deputetë.

48 deputetë kanë votuar “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, prandaj konstatoj se Kuvendi formoi Organin përzgjedhës të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, me këtë përbërje:

1. Rifat Zylfiu, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës;
2. Isak Ademi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, dhe
3. Besa Krajku, kryetare e Gjykatës Komunale në Prizren.

Të nderuar deputetë, me kaq po e përmbyllim punën e seancës së sotme plenare. Mirëupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve